



Krifca: KE vlerësime pozitive mbi bujqësinë, punojmë mbi rekomandimet

Faqe 3



Përafrimi i legjislacionit me BE, prioritet për sigurinë ushqimore

Faqe 4



Pagesa pjesore për 93 kontrata të IPARD II - Kushtet kur AZHBR financon përpara finalizimit të projektit

Faqe 4



AGROBIZNESI



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KESHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit tetor 2022

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 448
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

RAPORTPROGRESI PASQYRË E PUNËVE TË BËRA MIRË NGA MBZHR KE VLERËSON POZITIVISHT BUJQËSINË, ZHVILLIMIN RURAL, SIGURINË USHQIMORE DHE PESHKIMIN

Ministrja e Bujqësisë Frida Krifca deklaroi se "Ne jemi shumë mirënjohës për vlerësimet pozitive të reflektuara në raport siç jemi gjithashtu vigjilentë dhe duke punuar për rekomandimet e përcjella nga kolegët e sektorit në institucionet e Bashkimit Evropian, të cilat i vlerësojmë dhe kemi filluar punën për t'i adresuar"

RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

- Këshillimi i karrierës - Rruga për punësim

A e dini se kalimi nga edukimi drejt punësimit të paguar është një nga tranzicionet më të rëndësishme në jetën e një të riu? Është provuar se papunësia në fillimet e karrierës mund të prodhojë efekte afatgjata në perspektivën...



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri



Faqe 2



BKFSH

Të ndihmojmë fermerët në disa fronte kryesore të vjeshtës

Nga: Haziz Sava, Kryetari i B.K.F.SH

Faqe 7

KËNDI I EKSPERTIT

- Këshilla për fermerët perime rritës (QTTB Lushnje) Fq.11
- Këshilla për fermerët që mbarështojnë bagëti të imta (QTTB Korçë) Fq.11
- Këshilla dhe problematika për fermerët që kultivojnë bimë aromatike mjekësore (QTTB Shkodër) Fq.11
- Sëmundjet kryesore të ullirit (QTTB Vlorë) Fq.12
- Kalendari bujqësor, muaji nëntor 2022 - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

AGROTURIZËM

Agroturizmi, modele inovative me ndikim në ekonomi

Faqe 4

Krifca: Skema Kombëtare, mbështetje për mbi 40 mijë fermerë

Në Ditën Ndërkombëtare të Ushqimit, që shënon dhe ditën e themelimit të Organizatës Botërore të Ushqimit, (FAO) moto e të cilës është 'Mos Lër Askënd Pas', ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca...



Faqe 4

UBT

573 ekspertë dhe pedagogë të UBT-së, angazhim për informimin dhe trajnimin e fermerëve



Faqe 5

Këshillimi i karrierës - Rruga për punësim

A e dini se kalimi nga edukimi drejt punësimit të paguar është një nga tranzicionet më të rëndësishme në jetën e një të riu? Është provuar se papunësia në fillimet e karrierës mund të prodhojë efekte afatgjata në perspektivën për punësim dhe në të ardhurat e pritshme, që e vendos të riun në një pozicion vulnerabel në tregun e punës. Prandaj zyrat e karrierës në universitete marrin një rol të veçantë, për të rritur aftësitë e punësueshmërisë së studentëve, për t'i orientuar drejt profileve të degës së zgjedhur dhe për t'i lidhur sa më herët me tregun e punës.

Aida Shyti specialiste në sektorin e karrierës shprehet se është krenare për partneritetin me Karriera UAMD, të cilët kanë bërë hapa të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve cilësore të karrierës, që mbështesin këtë rrugëtim të rinjve!

Ne si zyrë ofrojmë shërbime për studentët nëpërmjet trajnimeve të ndryshme. Ne kemi bërë trajnime jo vetëm tani, por edhe më përpara kemi bërë trajnime. Edhe gjatë kohës së pandemisë kemi bërë

trajnime që ishin online, të cilët i zhvillojmë me studentët tanë, por edhe me studentët e gjimnazëve. Mundohemi t'i orientojmë studentët drejt tregut të punës, u tregojmë atyre si duhet të formulojnë një CV, si mund të bëjnë një letër motivimi, si mund të marrin pjesë në një intervistë, çfarë duhet të gjejnë tek vetja, përpara se të fillojnë të shkruajnë për veten.

Përveç trajnimit të stafit, i cili për mua është shumë produktiv dhe sjell shumë të reja në punën tonë të përditshme, patjetër shtimi i stafit është mëse i domosdoshëm sepse kapaciteti i studentëve, mundësia që ata të mbulohen sa më mirë, sepse studenti ka nevojë edhe për punë individuale, nuk mund të jetë gjithmonë në grup, në një seminar. Puna jonë konsiston edhe tek alonet. Alonet vijnë shpesh nëpër seminare dhe ndajnë eksperiencat e tyre që kanë pasur, punësimet e tyre aktuale, si kanë arritur gjithë historinë e tyre të suksesit. Kjo i afron goxha me zyrën tonë, kështu që shtimi i këtyre aktiviteteve, sidomos me alonet, për mua është vision.

Shembuj nga Alunet

Unë jam Erjeta Berisha dhe jam studente për "Navigacion dhe Menaxhim Detar". Unë këtë shërbim e marr sepse jam në vit të tretë dhe duhet të përballem me tregun e punës në të ardhmen. Ajo që më pëlqen më shumë është trajnimi për përgatitjen për letër motivimi, për CV, për intervistë, sepse kanë të bëjnë drejtpërdrejt me tregun e punës.

Unë jam Xhenisa Gjonaj (programi "Drejtësi") dhe jam studente e vitit të parë për drejtësi. Këshillimin po e marr më shumë për një orientim për degën për të cilën unë jam. Unë shërbimin e kam marrë që kur kam qenë në gjimnaz. Jam njohur bashkë me Aidën dhe në mendjen time ka qenë një degë tjetër që do të vazhdoja, ka qenë psikologjia, por me këshillat e Aidës, me punën që kemi bërë bashkë, kam ndërruar edhe degë dhe jam sot për drejtësi. Drejtësia ka qenë ëndrra ime që në fillimet e mia, por ndikimet e jashtme kanë qenë një ndryshim i vogël. Unë e kam rekomanduar tek shoqëria ime Zyrën e Këshillimit dhe ata aktualisht po orientohen për tregun e punës.

Si duhet të veprojnë eksportuesit për të mbrojtur tregjet që kanë dhe të hyjnë në tregje të reja

Enea Thomaj, ekspert në fushën e hortikulturës, në një intervistë për gazetën "Agrobiznesi", tregon mbi rëndësinë e certifikimit të prodhimeve bujqësore sipas standardeve të BE-së të krijojë hapësira shitje në tregjet me vlerë të lartë

Eksportet e fruta-perimeve kontribuojnë fuqishëm në Prodhimin e Brendshëm Bruto në Shqipëri, dhe kjo sigurisht që të bën të kthesh vëmendjen nga ky sektor i rëndësishëm.

Qëllimi i çdo Eksportuesi është të krijojë hapësira shitjeje

shumë i vogël i eksportuesve dhe kjo për arsye kryesore sikurse e përmenda më sipër, madhësisë së vogël të fermave.

Në këtë pikë lind nevoja që e detyron eksportuesin të marrë përsipër risqe dhe të rimendojë disa herë futjen në tregje të reja,

përkatese dhe të ketë një sinergizim të sektorit privat me institucionet shtetërore.

Në këtë fazë ku ne prodhojmë mbi 70% për eksporte, është i nevojshëm hartimi i politikave të cilat do të ndihmojnë fermerin dhe stimulojnë për të prodhuar me cilësi.

A ka hapësira pune për të rinjtë agronomë?

Bujqësia është një sektor i gjerë i ndarë në shumë nënsektore të tjerë, të cilët të gjithë janë në mangësi për agronomë dhe sidomos agronomë të rinj, energjikë dhe kërkues.

Është e çuditshme se si një sektor me mundësi të shumta punësimi preferohet më pak nga të rinjtë. Duke pasur mangësi mungon edhe konkurrenca për pozicionet e punës, çka bën që pagat në këtë profesion të vijnë në rritje dhe aktualisht një agronom i mirë paguhet shumë mirë në krahasim me pagat që janë në Shqipëri.

Sektori privat por edhe shtetëror ofrojnë mundësi punësimi për çfarëdo preferencash apo profilesh që një i ri me profesion agronom kërkon.

GlobalG.A.P certifikimi në grup. Cilat janë avantazhet? A janë të arritshme?

GlobalG.A.P është bileta e fermerëve për tregun e eksporteve në rajon, Europë dhe botë. Ajo çka nga vetë emri GlobalG.A.P nënkupton është "Good Agriculture Practices" pra Praktikën e Mira Bujqësore. Më sipër po ashtu i përmenda standardet dhe praktikën të cilat eksportuesit së bashku me fermerët duhet të planifikojnë së bashku për një qëllim të përbashkët.

Certifikimi i GlobalG.A.P është kthyer i nevojshëm dhe i padiskutueshëm për cilindo fermer apo eksportues i cili do të prodhojë me cilësi dhe standarde, për të synuar gjithmonë tregje me vlerë të lartë.

Një ndër modelet më të përhapura dhe më eficientë duke u nisur nga madhësitë e fermave që ne i disponojmë është certifikimi në grup i fermerëve. Ky model i certifikimit certifikon një grup fermerësh duke i ndihmuar të nxjerrin një produkt final cilësor dhe të arrijnë fitimet e merituar.

Ky model ka filluar të aplikohet gjerësisht në Shqipëri dhe të sjellë rezultate pozitive, ku qendrat eksportuese janë promotorët dhe ato që realizojnë punën më të madhe në hartimim dhe zbatimin e standardeve të GlobalG.A.P.

Certifikimi GlobalG.A.P është e vetmja mënyrë për fermerin që të rrisë vlerën e produktit të vet dhe të konkurrojë në rajon, Europë, e jo vetëm.



Enea Thomaj, ekspert në fushën e hortikulturës

Kompania Esencial prodhon dhe eksporton 45 ekstrakte nga bimët medicinale aromatike të trevave të Shqipërisë

Lindita Vrushi CEO Esencial, në një intervistë dhënë gazetës "Agrobiznesi" mbi ecurinë e kompanisë Esencial që operon në fushën e BAM

Përmbledhje mbi produktet e prodhuara nga Kompania Esencial

Kompania Esencial ka në fokus dhe si objektivi madhor prodhimin e ekstrakteve në gjendje të ngurtë nga bimët medicinale aromatike të trevave të Shqipërisë.

Këto ekstrakte të njohura si Ekstraktet Totale të CO2 përbëjnë lëndën e parë për disa sektorë industrialë si me poshtë: Farmaceutikë, Kozmoceutikë, Produkte të ku-

- Konsum të CO2 në prodhim
- Ruajtje e tokës dhe mjedisit
- Vlera të shtuara nga bimët dhe burime të reja prej tyre
- Produkt sinergjik me vlera ekonomike
- Laboratori dhe departamenti R&D pika të forta të kompanisë.

Cili është potenciali i BMA-ve dhe cilat janë produktet e reja të kompanisë suaj?

Potenciali i BMA është i

qelizat tona janë procese unike dhe të faktuara nga studimet prestigjioze në universitete me spektër akademik farmacinë dhe mjekësinë. Më tej fusha e aplikimit zgjerohet dhe në gamën ushqimore të njerëzve dhe kafshëve.

Në kompaninë tonë ne kemi një portofol me 45 lloje ekstraktesh nga MBA. Për secilin ne kemi përgatitur studimet mbi komponimet kimike dhe vetitë e tyre në nivelin e principit aktiv.

Përmenden këtu vetitë e frutit të shtogut, të dafinës, borzilokut, agulices, akacias, gjineshtrës e



qesdit të lëkurës dhe flokëve, Suplemente ushqimore, Kulinar, Kozmetikën e bukurisë, Aromaterapi, Farmacinë bujqësore dhe veterinarë.

Më poshtë gjeni të ilustruara të dhëna konkrete të kompanisë tonë:

- Zero emetim CO2
- Teknologji e gjelbër

njohur që në lashtësi për vetitë e tyre shëruese dhe ushqyese. Në ditët e sotme ku studimet bëhen në nivele të larta shkencore, BMA-të mbeten të vetmet burime natyrore me principe aktive të rëndësishme për proceset fiziologjike, që ndodhin në organizat njerëzore.

Mekanizmat e veprimit mbi

plot e plot bimë të tjera. Së fundmi ne kemi prodhuar ekstrakte dhe nga mbetjet e përpunimit të ullirit (pomace) ku kemi gjetur sasi të mëdha të tokoferolebe që quhen ndryshe përbërës të vitaminës E. Gjithashtu kemi gjetur dhe fitokomponime të

(Vijon në faqen 5)

RAPORTPROGRESI PASQYRË E PUNËVE TË BËRA MIRË NGA MBZHR

KE VLERËSON POZITIVISHT BUJQËSINË, ZHVILLIMIN RURAL, SIGURINË USHQIMORE DHE PESHKIMIN

Ministrja e Bujqësisë Frida Krifca deklaroi se “Ne jemi shumë mirënjohës për vlerësimet pozitive të reflektuara në raport siç jemi gjithashtu vigjilentë dhe duke punuar për rekomandimet e përcjella nga kolegët e sektorit në institucionet e Bashkimit Evropian, të cilat i vlerësojmë dhe kemi filluar punën për t'i adresuar”

Raporti i progresit i publikuar nga Komisioni European për periudhën shtator 2021 - shtator 2022, ka vlerësuar pozitivisht ecurinë e punës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Duke u ndalur në secilin sektor, si bujqësia dhe zhvillimi rural, siguria ushqimore dhe peshkimi, Komisioni European në dokumentin e përvitshëm të matjes së performancës së Shqipërisë në përafrimin e politikave dhe ligjeve me Bashkimin European rendit arsyet e rezultateve pozitive të bujqësisë shqiptare.

Në lidhje me zhvillimin rural, Komisioni European shpreh se Ministria e Bujqësisë

veprimet për implementimin e plotë të saj.

Gjithashtu lidhur me kërkesën e raportit të progresit për ligjin e shëndetit të kafshëve dhe ligjin e mbrojtjes së bimëve, tashmë ato janë në proces draftimi me asistencë ndërkombëtare bazuar në rregulloret e BE-së.

Gjithashtu për sa i përket kërkesës për plotësimin e trupës veterinarë, nga 167 veterinerë në prill të vitit 2021, tashmë janë 444 veterinerë në terren të cilët garantojnë shëndetin e kafshëve.

Më tej në fushën e sigurisë ushqimore, ashtu si kërkohet dhe nga Komisioni European, është miratuar i plani i survejancës me bazë risku për

funksionimin e Sistemit të Monitorimit të Aniëve (VMS) dhe shpërndarjen e burimeve njerëzore për të monitoruar dhe raportuar mbi aktivitetin e aniëve të peshkimit.

Gjithashtu, raporti vlerëson mbështetjen e dhënë për anijet e peshkimit sipas skemës së bashkëfinancimit me 50% të investimit duke theksuar se qeveria ka prezantuar masa të reja mbështetëse financiare për sektorin e peshkimit si pjesë e programit kombëtar të financimit për bujqësinë dhe zhvillimin rural 2022 si dhe ndërtimin e Markatave në Shëngjin dhe Vlorë.

Vlerësimi pozitiv bëhet edhe për testet në sistemin pilot të raportimit elektronik (ERS)

Krifca: KE vlerësimet pozitive mbi bujqësinë, punojmë mbi rekomandimet

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca foli mbi progresraportin e Komisionit European, duke u ndalur te kapitujt e bujqësisë, zhvillimit rural, sigurinë ushqimore dhe peshkimit.

Krifca tha se “raportprogresi i dorëzuar sot nga Komisioni European për Shqipërinë për vitin 2022 ofron një pasqyrë të punëve të bëra mirë e me vrull nga ekipi i Ministrisë së Bujqë-

e re moderne në pikat e rëndësishme kufitare, në pikat e hyrjes, për sa i takon kontrollin ushqimor me volume të mëdha si në pikën e Kapshticës, Kakavijës së Bllatës, në portin e Durrësit, të Vlorës, ku pas zbatimit të këtij programi do të ketë një realitet të ri të zbatimit të kontrolleve të përafruar me standardet e Bashkimit Evropian”, vijoi ministrja.

“Kemi çuar më tej Reformën e Shërbimit Veterinar dhe kemi plotësuar strukturën me mbi 500 veterinerë në territor, të cilët sot matrikullojnë, gjurmojnë e vaksinojnë falas për fermerët. Kemi përmirësuar zinxhirin e gjurmueshmërisë në ferma, në tregjet e kafshëve të gjalla, në thertore dhe pikat e tregtimit. Mirëpresim ende, në fakt veterinerë të rinj që me vrull mund t'i bashkohen ekipit të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë. Kemi hedhur hapat e para për zbatimin e Rregullores Evropiane 625 të cilat zbatohen kontrollet zyrtare”, vijoi ajo.

Krifca tha po ashtu se është rritur gama e testeve laboratorike të akredituara dhe vazhdon procesi i zgjerimit për të siguruar besueshmëri në kontrollet laboratorike.

“Kemi miratuar Dokumentin Kombëtar për Sigurinë Ushqimore dhe Planin 10-vjeçar të Përdorimit të Qëndrueshëm të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, dy dokumente këto që do të drejtojnë punën afatgjatë për mbështetjen e sektorit”, tha Krifca.

Ministrja theksoi se me mbështetjen e Bashkimit Evropian, po hartohen tre ligje, që do të plotësojnë kuadrin rregullator për kontrollin zyrtar, për shëndetin e bimëve dhe shëndetin e kafshëve.

“Komisioni European ka vlerësuar mjaft pozitivisht punën që kemi bërë këtë vit dhe hapat konkrete të ndërmara për mbështetjen e peshkimit me mbështetje financiare ofruar për infrastrukturën e aniëve dhe përmirësimin e flotës së saj, me ndërtimin e markatave, atë të Shëngjinit, të Vlorës, e cila është përfunduar. Ka vlerësuar pozitivisht urat që kemi vendosur në bashkëpunimin ndërkombëtar në këtë fushë, ku gjithashtu është përmendur ky sukses”, tha ajo.

Krifca siguroi se do të vijojë angazhimet për të garantuar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore të gjalla dhe promovimin e një ekuilibri të qëndrueshëm midis burimeve dhe kapaciteteve të peshkimit të flotës.

“Ne jemi shumë mirënjohës për vlerësimet pozitive të reflektuara në raport siç jemi gjithashtu vigjilentë dhe duke punuar për rekomandimet e përcjella nga kolegët e sektorit në institucionet e Bashkimit Evropian, të cilat i vlerësojmë dhe kemi filluar punën për t'i adresuar. Ky është një rrugëtim i gjatë, një përmirësim i vazhdueshëm dhe në këtë proces duam mbi të gjitha të fuqizojmë, të zhvillojmë, të mbështesim bujqësinë shqiptare, sektorin e peshkimit dhe të sigurojmë sa më parë përputhshmërinë me të lartë me standardet e Bashkimit Evropian në këto tre fusha”, theksoi ministrja.

Në raportin e progresit Shqipëria vlerësohet pozitivisht edhe për rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve për miratimin e programit IPARD III i cili do të ketë një rritje të buxhetit të mbështetjes me 54% duke arritur në 146 milionë euro, me rritje edhe të kategorive të masave mbështetëse.

ka realizuar dhe përbushur kërkesën e rekomandimeve të kaluara për krijimin dhe ngritjen e regjistrit të fermës, si instrumenti që garanton zbatimin e praktikave të mira të prodhimit të vendeve të zhvilluara.

Në raportin e progresit Shqipëria vlerësohet pozitivisht edhe për rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve për miratimin e programit IPARD III i cili do të ketë një rritje të buxhetit të mbështetjes me 54% duke arritur në 146 milionë euro, me rritje edhe të kategorive të masave mbështetëse.

Raporti thekson gjithashtu dhe suksesin në administrimin dhe zbatimin e programit IPARD II në realizimin e plotë të objektivave.

Komisioni European vlerëson pozitivisht ecurinë edhe në sektorin e sigurisë ushqimore, ku krahas vlerësimit për punën e realizuar thekson edhe disa detyra të cilat janë në proces. Lidhur me adoptimin e strategjisë kombëtare të sigurisë ushqimore ka përfunduar procesin i draftimit si dhe konsultimi publik. Brenda vitit 2022 përfundon miratimi i strategjisë shoqëruar me planin e

sëmundjen e Influcës Avjare në shtator 2022, ndërkohë që Ministria është në përfundim të planit të survejancës për Murtajen Afrikane të derrave si dhe janë marrë masat për fillimin e fushatës së vaksinimit kundër



tërbimit për vitin 2022.

Në sektorin e peshkimit Komisioni European vlerëson se Shqipëria ka bërë progres të dukshëm, veçanërisht në

dhe përpjekjeve për plotësimin e bazës ligjore në këtë drejtim. Raporti lë detyra në lidhje me peshkimin e vogël artizanal, nevojës së miratimit të Zonave të përcaktuara për Akuakulturën për Shëngjinin,

Durrësin dhe Vlorën, si një sektor relativisht i ri për Shqipërinë, por me një potencial të madh zhvillimi ekonomik dhe punësimi.

Krifca në Irlandë: Përafrimi i legjislacionit me BE, prioritet për sigurinë ushqimore

Përafrimi i legjislacionit të sigurisë ushqimore dhe zbatimi i rregullave dhe standardeve evropiane për këtë sektor në Shqipëri është prioritet i qeverisë shqiptare dhe Ministrisë së

në Irlandë për të ndjekur nga afër ecurinë e deritanishme të bashkëpunimit me autoritetet e Irlandës sipas projektit dis-avjeçar të sigurisë ushqimore.

Ministrja është takuar dhe

qimore, të Autoritetit Irlandez të Sigurisë Ushqimore si dhe të Laboratorit Shtetëror Referencë të shtetit të Irlandës.

E shoqëruar nga ministri i Shëndetit Publik dhe Mirëqenies të Irlandës, Frank Feighan, ministrja Krifca ka vizituar dhe Drejtorinë e Portit të Irlandës për të parë nga afër procedurat evropiane të kontrollit, pasi Shqipëria ka miratuar një projekt prej 25 milionë euro me Bankën Botërore për zbatimin e rregullores evropiane për respektimin e standardeve të sigurisë ushqimore në pikat kufitare në Qafë-Thanë, Kapshticë, Durrës dhe Vlorë.

Ministrja ka folur dhe për sigurinë ushqimore si instrumenti më i rëndësishëm për rritjen e cilësisë së prodhimit bujqësor, rritjen e eksporteve, rritjen e të ardhurave të fermerëve dhe garantimin e cilësisë së produkteve për konsum.



Bujqësisë.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, ndodhet në një vizitë në Dublin

ka diskutuar me përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Komisionit Evropian për Shëndetin dhe Sigurinë Ush-

IPARD II, 92 kontrata investimi në agropërpunim

Industria e agropërpunimit është një ndër sektorët me potencial të madh në zhvillimin

bujqësor dhe Rural (AZHBR) ka nënshkruar 92 kontrata për investime në makineri dhe

vajit, verës etj.

Në sajë të këtyre investimeve është bërë e mundur ndjekja e gjithë ciklit të prodhimit, që nga seleksionimi, përpunimi dhe realizimi i paketimit të produktit.

Pajisjet e reja në industrinë e agropërpunimit kanë sjellë rritje të standardeve dhe kapaciteteve prodhuese, duke synuar përveç tregut vendas, edhe atë të jashtëm. Gjithashtu, rendimenti i lartë i punës ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e punësimit.

Granti i dhënë për industrinë e agropërpunimit kap vlerën prej 22.3 milionë euro, nga fondet e Bashkimit Europian në bashkëfinansim me qeverinë shqiptare.



e ekonomisë dhe si e tillë është mbështetur në të 3 thirrjet e programit IPARD II.

Agjencia për Zhvillim Bu-

pajisje agropërpunuese, ndër të cilat pajisjet e përpunimit të frutave dhe perimeve, linjën e përpunimit të qumështit,

Agroturizmi, modele inovative me ndikim në ekonomi

Agroturizmi po përjeton një rritje të shpejtë, ku nga pak emra që numëroheshin me gishtat e njëjës dorë, sot Shoqata e Agroturizmit e sapokrijuar, ka 71 anëtarë dhe parashikon rritje.

Sipërmarrjet në agroturizëm ia kanë dalë të amortizojnë disi efektet e rritjes së kostove, falë ciklit të prodhimit të produkteve në fermat e tyre, apo pasurimit të ofertës me dimensione të reja.

Gjithsesi edhe pse ky sektor po shkon drejt konsolidimit, operatorët shprehen se ka ende shumë punë për të mbështetur sipërmarrjet agroturistike, që konsiderohet si katalizator i fshatit dhe

bujqësisë.

Ekspertët e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në bashkëpunim me ata të huaj, diskutuan me shoqatën e agroturizmit për planifikimin e fazën e dytë të projektit për "Zhvillimin e qëndrueshëm rural", që fillon në janar të vitit 2023.

Ndalesa e parë ishte në Kolonjë me agroturizmet e Kolonjës, Korçës, Përmetit, Tepelenës, Pogradecit, Këlcyrës, Beratit, etj., dhe ndalesa e dytë në Lezhë me agroturizmet e Mirditës, Lezhës, Malësisë së Madhe, Pukës etj.

Disa nga çështjet që u trajtojnë me sektorin privat të agroturizmit ishin kthimi i sfidave

dhe problematikave në ide konkrete, cilët janë aktorët që duhet të përfshihen dhe si mund të kontribuojë gjithsecili.

Gjithashtu bashkë me aktorët e linjës, u zgjedhën dhe modelet inovative me ndikim në ekonomi dhe sektor me potencial përshkallëzimi në të gjithë territorin.

Vitin e fundit, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, disbursoi përmes programit IPARD II, një buxhet prej 5.2 milionë euro në mbështetje të agroturizmit.

Programi IPARD II, dha grant 65 % të vlerës për investime në agroturizëm që kapnin vlerën nga 10 mijë deri 400 mijë euro.

Pagesa pjesore për 93 kontrata të IPARD II - Kushtet kur AZHBR financon përpara finalizimit të projektit

Për t'iu përgjigjur nevojës dhe vështirësive financiare të fermerëve, agropërpunuesve dhe turizmit rural për përthithjen dhe zbatimin e Programit IPARD II, Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural do të aplikojë mekanizmin e financimit me pagesa pjesore të investimeve IPARD.

Konkretisht sipas AZHBR, janë 93 kontrata aktive, të cilët mund të përfitojnë nga financimi me pagesa pjesore sipas situacioneve të punimeve të ndërtimit apo rikonstruksionet. Ky financim ndihmon në përfundimin e investimeve në kohë.

Pagesa pjesore do të jetë e vlefshme edhe për kontratat e thirrjes III dhe IV të programit IPARD-II. Më pas AZHBR do të kryejë verifikime në terren për zërat e realizuar në investim, para realizimit të pagesës dhe pas realizimit të investimit do të kryhet pagesa e mbetur, sipas parashikimit në kontratës.

AZHBR bën me dije se pagesa pjesore e përfutur cilësoret nga autoriteti kontraktues si shpenzim i pranueshëm, kur është realizuar minimalisht 60% e investimit lidhur me projektin që përmban punime

ndërtimi/rikonstruksioni, e cila do ti nënshtrohet vendosjes së një garancie bankare ose ekuivalente me të.

Afati i vlefshmërisë së garancisë bankare është 6 muaj nga përfundimi i afatit të zba-

dhe nuk kanë marrë një pagesë finale, të cilët do të ftohen për kryerjen e amendimit të kontratave si dhe aplikantët që do të kontraktohen në vijim nën IPARD II.

Dokumentat që praqiten



timit të investimit sipas Kontratave individuale me përfuturitet. Garancia e paraqitur do të kontrollohet për vlefshmërinë nga Agjencia IPARD me kërkesë të thjeshtë për institucionet që lëshojnë dokumentin.

Referuar AZHBR, në rast se subjekti ka përfuturitet nga pagesa paraprake, në llogaritjen e pagesës pjesore vlera e marrë me pagesë paraprake do të zbritet. Kjo procedurë do jetë e aplikueshme vetëm për përfuturitet që janë kontraktuar

pranë AZHBR janë: Kërkesë me shkrim për pagesën pjesore; -Faturat Originale për shpenzimet e ndodhura; Situacionet përkatëse për realizimin e punimeve; Libreza e masave; Garancia bankare ose garancia e sigurimit të Kontratës; Dokument identifikimi, i vlefshëm; Numri i Llogarisë bankare (IBAN) sipas Kontratës. Kjo procedurë që synon pagesën në kohë të fondeve të alokuara nga BE si dhe rritjen e përthithjes e buxhetit për këtë Program.

Krifca: Skema Kombëtare, mbështetje për mbi 40 mijë fermerë

Në Ditën Ndërkombëtare të Ushqimit, që shënon dhe ditën e themelimit të Organizatës Botërore të Ushqimit, (FAO) moto e të cilës është 'Mos Lër Askënd Pas', ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca tha se "vetëm këtë vit qeveria ka mbështetur me 4.9 miliardë lekë fuqizimin e fermerëve prodhues përmes Skemës Kombëtare".

Në një postim në rrjetet sociale, Krifca tha se "përmes Skemës Kombëtare të Mbështetjes deri më sot janë

mbështetur mbi 40 mijë fermerë".

Krifca vuri në dukje se, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, është pjesë e kësaj organizate dhe së bashku me të udhëheq një mori projektesh me synim objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.

"Kjo ditë sjell vëmendjen ndaj rëndësisë së ushqimit të shëndetshëm, me vlera të larta ushqyese, mosshpërdorimin e ushqimit dhe balancimit të ushqimit në kalori si baza e jetës", theksoi Krifca.

Ministrja e Bujqësisë informoi se, përmes bashkëpunimit me FAO-n, po ndjekim disa projekte dhe investime transformuese, ndër të cilat rregullimin e kuadrit ligjor për prodhimin organik; përmirësimin e standardeve të sigurisë ushqimore në zinxhirin e prodhimit të produkteve tipike lokale shqiptare; përmirësimin e cilësisë dhe përputhshmërisë me standarde për zinxhirët e zgjedhur të vlerës për blegtorinë dhe mbështetjen për sigurinë ushqimore.

40 % e financimit nga IPARD, për sipërmarrjet nga gratë e zonave rurale

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, ka mbështetur gratë në zonat rurale me financime direkte për blegtorinë, bletarinë, fermat organike, peshkimin.

40 % e financimit nga programi IPARD shkon për sipërmarrjet nga gratë rurale në grante për investimet në ferma, sipërmarrje agropërpunuese dhe turizëm rural.

Nëpërmjet kësaj mbështetje synohet fuqizimi ekonomik i grave në fshat. Ndërsa roli i grave në ekonominë dhe zinxhirin e vlerës në zonat rurale shkon përtej prodhimit.

Organizimi i grave rurale në shoqata, u ka mundësuar atyre



të përfitojnë edhe nga skemat e mbështetjes financiare, për të zhvilluar biznesin në fushën e

agropërpunimit të prodhimeve bujqësore, por edhe të artikuljeve tradicional të zonës së tyre.

573 ekspertë dhe pedagogë të UBT-së, angazhim për informimin dhe trajnimin e fermerëve

573 ekspertë dhe pedagogë të Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT) janë angazhuar në kuadër të Skemës Kombëtare të Trajnimit në Bujqësi, për informimin dhe trajnimin e mbi 2 mijë fermerëve në të gjithë vendin, në fushën e teknologjisë bashkëkohore, ku përfshihen praktikrat e reja në ndihmë të punës së tyre.

Nisma e ndërmarrë nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, u prezantua sot në një takim me aktorë të fushës, në ambientet e UBT-së, ku ishte i pranishëm edhe Kryeministri Edi Rama.

Duke marrë fjalën në këtë takim ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca tha se, "ky projekt vjen në vazhdim të një sërë takimeve publike që ne kemi zhvilluar në terren në të gjithë vendin, me fermerë dhe agropërpunues,

ku kemi dialoguar për t'i dhënë zgjidhje dhe ndihmuar fermerët në zhvillimin e aktivitetit bujqësor".

"UBT është një partner i rëndësishëm për Ministrinë e Bujqësisë që kontribuon dhe ka mision të veçantë në çarjen përpara të zhvillimit të bujqësisë dhe agropërpunimit, mbi bazat e inovacionit dhe teknologjive bashkëkohore", theksoi ministria.

Krifca vuri në dukje se nëpërmjet idesë dhe informacionit koherent, garantohej rritje e rendimentit të prodhimit, standarde dhe cilësi që e bëjnë prodhimin bujqësor më konkurrues në tregje.

"Ne vendosëm që në Skemën Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi për vitin 2022, të lancojmë për herë të parë dhe Skemën Kombëtare të Trajnimit në Bujqësi,

ku ekspertët e fushës që do të asistojnë fermerët, blegtorët dhe përpunuesit me praktikrat më të mira në çdo drejtim të prodhimit, për mbarështimin e perimeve dhe drufrutorëve, sistemet e mbarështimit të kafshëve dhe të ushqyerit e kafshëve, ndryshimet klimatike dhe efekti i tyre në prodhimin bujqësor dhe blegtoral si dhe për hartimin e planeve të biznesit dhe kooperimin në bujqësi", u shpreh Krifca.

Ministria theksoi se ky program trajnimi garanton përmirësimin cilësor të fermave dhe ekspertët do t'i përgjigjen fermerëve për çdo nevojë që ata kanë duke përçuar avancimin e implementimit të teknologjive të reja në prodhim, me ndikim në uljen e kostove dhe rritjen e cilësisë për të projektuar zhvillimin konkurrues të bujqësisë shqiptare.

Rama: Kapitull i ri i marrëdhënieve mes UBT-së dhe prodhuesve bujqësorë

Kryeministri Edi Rama mori pjesë në ceremoninë e organizuar në Universitetin Bujqësor të Tiranës për prezantimin e skemës kombëtare për të ardhmen e prodhimit vendas.

Kryeministri tha se me këtë program do të hapet një kapitull i ri i marrëdhënieve mes universitetit dhe prodhuesve bujqësorë.

Sips tij, "1800 fermerëve do t'u jepen trajnime me specialistë të teknologjisë së fundit, ku përfshihen praktikrat e reja në ndihmë të punës së tyre".

"Me këtë program ne hyjmë

në një fazë të re. U them të gjithë pedagogëve që kjo nuk është një nismë që bëhet tani dhe ndalet tani, por është një nismë që ne duam të mbetet në vazhdimësi, të jetë e programuar, të përmirësohet hap pas hapi nga eksperienca, nga rezultatet, nga çfarë do të sugjeroni ju dhe çfarë do të shohim në terren", tha ai.

Kryeministri tha se ky program është eksperienca e parë në 40 vjet.

"Nëse në 30 vitet e fundit ky universitet ka pasur një periudhë rrëshqitje në humnerë dhe

pastaj një periudhë ngritje të ngadaltë dhe të mundimshme, por ende jo aty ku ne duam të jetë, në ato vitet e mëparshme ka qenë një institucion ekselence europiane, jo thjesht shqiptare. Pavarësisht ideologjisë, mbylljes, kushteve dhe mundësive më të pakta këtu, ne kemi pasur një nga të pakta oaze të dijes dhe shkencës që ishte në nivel europian. Marrëdhëniet dhe reputacioni i këtij universiteti edhe në botën akademike europiane të asaj kohe dihet që kanë qenë shumë të respektueshme", shtoi ai.

Negociatat Manjani: Hapa konkretë drejt lëvizjes së lirë të punëtorëve

Komisioni Evropian dhe delegacioni shqiptar i kryesuar nga zëvendësministria e Financave dhe Ekonomisë, Olta Manjani, zhvilluan në Bruksel, takimin shpjegues për Kapitullin 2 "Lëvizja e Lirë e Punëtorëve".

Liria e lëvizjes së punëtorëve është një nga liritë themelore të garantuara nga ligji i Bashkimit Evropian.

Zëvendësministria Manjani u shpreh se Shqipëria

ka bërë hapa konkrete drejt lëvizjes së lirë të punëtorëve duke përafuar kuadrin ligjor kombëtar me acquis të BE-së, për të promovuar lirinë e lëvizjes së punëtorëve dhe shkëmbimin e informacionit mbi mundësitë e punësimit.

Acquis, sipas këtij kapitulli parashikon që, qytetarët e BE-së të një shteti anëtar kanë të drejtë të punojnë në një shtet tjetër anëtar. Një-

kohësisht, punëtorët migrantë të BE-së duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë si punëtorët vendas në lidhje me kushtet e punës, avantazhet sociale dhe tatimore.

Acquis përfshin gjithashtu një mekanizëm për të koordinuar dispozitat kombëtare të sigurimeve shoqërore për personat e siguruar dhe anëtarët e familjeve të tyre që lëvizin në një shtet tjetër anëtar.

Kompania Esencial prodhon dhe eksporton 45 ekstrakte nga bimët medicinale aromatike të trevave të Shqipërisë

(Vijon nga faqja 2)

tjera me rëndësi ekonomike.

Si është potenciali për eksport?

Kompania jonë këto lëndë i prodhon për eksport. Është një sfidë e madhe pasi në një kontratë eksporti pika kyçe është dhe vazhdimësia dhe

produkti i standardizuar në Shqipëri, hasim shumë po shumë vështirësi për të standardizuar produktin përfundimtar. Pika jonë e dobët është kultivimi dhe sipërfaqet e tokës të pakontrolluara dhe të pastandardizuara për një kulturë të caktuar. Ne si prodhues mund të prodhojmë sasi për kërkesat e eksportit,

mbështetur në teknologjinë tonë të avancuar dhe njëkohësisht miqësore me mjedisin por mungesa e BMA-ve të standardizuara na veshtrëson shumë gjithë zinxhirin e prodhimit.

Kjo në përmblylljen e disa kontratave na ka cuar të importojmë bimë nga rajoni. Kjo gjë ka kosto dhe vonesa përsëri.

Merr jetë Kampusi i ri i Universitetit Bujqësor të Tiranës

Kryeministri Edi Rama, së bashku me ministren e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca dhe nënkryetarin e bashkisë së Tiranës, Arbjan Mazniku inspektoi kampusin

gjejë studentët e Universitetit Bujqësor të Tiranës me godina të reja studentore.

Nënkryetari Mazniku shpjegoi se dy prej godinave janë gati që këtë vit akademik në



universitar të Universitetit Bujqësor të Tiranës, për të parë nga afër ndërtimin e kompleksit rezidencial, ku do të sistemohej studentët dhe njësitë e kërkimit shkencor.

Viti i ri akademik do t'i

shërbim të studentëve.

"Në pak muaj grupet e para janë gati që të futen që tani. Janë tetë godina. Për momentin zihen dy të parat që janë bërë gati dhe në janar grupi i dytë", tha ai.

Mazniku bëri të ditur se godina do të shërbejnë jo vetëm si konvikte, por dhe si mjedise për kërkimin shkencor dhe për startup-e, duke krijuar një lidhje mes studentëve dhe biznesit.

"Siç ka qenë dhe ideja fillëtare, një pjesë e objekteve kanë funksion përtej konvikteve. Objekti që është ende në punim ka dhe një hapësirë të hapur që te ketë mundësi të përdoret eventalisht si një qendër e kërkimit shkencor në bashkëpunim dhe me Universitetin Bujqësor. Godinat janë të gjitha të një niveli shumë të mirë dhe të avancuar për të qenë konvikte, të gjitha dhomat janë dyshe dhe me banjo brenda saj. Kjo është godina e kërkimit shkencor. Nga brenda ajo është si një hapësirë e hapur që të kemi mundësi që i gjithë kampusi të marrë një fokus të ndërveprimit mes universitetit, studentëve dhe të kërkimit shkencor dhe të teknologjive për startup-e", nënvizoi Mazniku.

Gratë rurale përballë sfidave të ekonomisë bujqësore dhe patriarkatit

Dake Gjoni prej 18 vitesh koordinon punën e një grupi grash rurale në Qelëz, Pukë për prodhimin e produkteve bio për tregun lokal dhe kombëtar.

"Nëse gratë para 15 vitesh kanë qëndruar të izoluar në shtëpi, sot ato janë përditë pjesë e tregut", tregon ajo.

Megjithëse ky grup kultivon dhe përpunon produkte bio të cilësisë së lartë, Gjoni ngre shqetësimin e mungesës së certifikimit, që ia kufizon tregun.

"Ne kërkojmë të bëhet certifikimi i produkteve tona, të serës, të produkteve bujqësore, blegtorale në mënyrë që kur konsumatori vjen dhe blen në treg të jetë i garantuar për cilësinë e prodhimit", vijon ajo.

Historitë e grave në zona të ndryshme të Shqipërisë janë të ngjashme. Beruze Çakalli nga Elbasani, kujton fillimet e vështira të organizimit të grave në zonat rurale, të cilat u bënë bashkë për të sfiduar mendësinë patriarkale.

"Ka qenë pak e vështirë, jo ku do ikni juve, jo po gratë nuk duhet të ikin pa burrat, kishte mënyra të ndryshme që nuk mund t'i lejonin gratë të vinin të merrnin pjesë në aktivitet që ne organizuam", tha për Citizens Channel Beruzja e cila sot është pjesë e një grupi prej mbi 20 grash aktive në Federatën Bujqësore Elbasan.

Engjellushe Pepaj nga Grupi i Grave në Qelëz të Pukës tregon se në fillim kishte turp të dilte në treg për të shitur produktet e saj.

"Nga fruti i parë deri te i fundit, nga hurma te luleshtrydhja, i mbleddim, i përpunojmë, i thajmë, edhe frutat i konservojmë në lëngje, reçel etj.", pohon ajo.

Pepaj shton se puna në grup e ka shndërruar sot në një fermerë aktive.

"Tani unë ku dëgjoj që ka panairë, ku dëgjoj që ka ditë tregu unë dal me produktet e mia; sepse edhe një i moshuar

të ndërhyjë dhe të mbështesë grupet e grave rurale, të cilat fatmirësisht janë ekzistente, në formalizimin e aktivitetit", tha Maria Frroku, përfaqësuese e grupit të grave Gjegjan, Pukë.

Evelina Azizaj, Koordi-



këtu në zonën tonë dikur thoshte: 'Po se shite produktin tënd nuk ja di vlerën dhe kjo është shumë e vërtetë', përfundon ajo.

15 Tetor Dita Ndërkombëtare e Gruas Rurale

"Sot, vetëm 8% e fermave në Shqipëri drejtohen nga gratë. Gratë në zonat rurale përballen me diskriminime të ndryshme që kanë të bëjnë me pabarazi në vendimmarrje, stereotipe gjinore si dhe me ndarje të pabarabartë të kontributit dhe të punës së papaguar", tha Estela Bulku, Drejtuese e Programeve të UN Women në Shqipëri.

Më datë 15 tetor shënohet Dita Ndërkombëtare e Gruas Rurale dhe për të katërtin vit radhazi gra dhe vajza nga Kolonja, Korça, Elbasani dhe Puka u mbledhën për të diskutuar sfidat e tyre në takimin "Pro-grave Rurale".

"Po të shohësh duart e grave rurale është për t'i vënë duart kokës dhe ndaj i bëj thirrje pushtetit vendor

natore Kombëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillim Rural theksoi se "Pro Grave Rurale" shërben si një mundësi për të bërë të ndërgjegjshëm institucionet dhe aktorët të angazhuar, mbi rëndësinë e rritur për instrumente dhe veprime konkrete për të përmirësuar mirëqenien e vajzave dhe grave në zonat rurale.

Zëvendës Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ermira Gjeci, premtoi se problematika e formalizimit të aktivitetit të grave në zonat rurale do të gjejë zgjidhje nëpërmjet iniciativës së re për barazi gjinore rurale.

"Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Agjencitë e Kombeve të Bashkuara për Ushqim dhe Agrikulturë dhe Gratë, janë angazhuar me anë të projektit GREAT të arrijnë zhvillimin e kapaciteteve të grave nëpërmjet formalizimit të aktivitetit të tyre, forcimin e rolit dhe kontributit të tyre në zhvillimin rural", përfundoi ajo.

AKTUALITET

Rama: Do ndërtojmë markatë peshku në Durrës

Mbështetja e qeverisë ndaj sektorit të peshkimit dhe sfidat e zhvillimit të kësaj industrie përgjatë vitit, 2022 ishte tema e një takimi të zgjeruar me sipërmarrës dhe punonjës të sektorit të peshkimit.

Takimi, në të cilin mori pjesë edhe Kryeministri Edi Rama u zhvillua në portin e peshkimit në Durrës, ku sot nisi puna për zgjerimin e kapaciteteve ankoruese për anijet e peshkimit, një investim i shumëpritur dhe tejet lehtësues për peshkatarët.

Në fjalën e tij, Kryeministri u shpreh se duhet ta çojmë realisht flotën në një standard tjetër.

“Ju e keni të gjithë eksperiencën, ju i keni të gjitha energjitë që ju duhen, ne duhet vetëm t’ju mbështesim. Ku kishte bërë vaki ndonjëherë që komuniteti i peshkimit të futej në procese aplikimesh për fonde? Edhe logjistika nuk është mjaftueshëm thjeshtë flota ose përmirësimi i flotës, na duhet të rrisim standardet e porteve të peshkimit, siç po bëjmë këtu sot. I erdhi koha edhe kësaj faze tjetër, mbasi u garantua që porti është i juaji e nuk kishte realisht shans ta rrëmbejnë për qëllime të tjera, siç u përpoqën shumë të fillimit fare, por tani duhet të rrisni standardin. Lajmi i mirë është që e ardhmja jo shumë e largët është jo shumë më e bukur se e sotmja, sepse gjithë kjo zonë, siç jua kam treguar, por tani jemi pranë realizimit dhe fillimit të punës, do të kthehet në një zonë turistike”, tha Rama.

Kryeministri informoi se këtu do të ndërtohet një markatë peshku, me ambicien për të qenë një nga markatat më të bukura të Mesdheut.

“Do të ndërtojmë një markatë peshku, më të bukurën e të gjithave që janë bërë deri tani, që janë të mira, që i plotësojnë kushtet. Ajo e Vlorës është jashtëzakonisht e mirë por të shkojë përtej, që të jetë diçka me ambicien për të qenë një nga markatat më të bukura të Mesdheut, të peshkut dhe në të gjithë zonë këtu do të ndërtojmë një rrugë këmbësore me gjithë restorante, klube që do

jenë të lidhura sigurisht, me detin dhe punën tuaj. Pra dhe markata dhe rruga këmbësore njëloj, bulevardi dhe gjithë tregtia turistike, që do të bëhen si rezultat i faktit që gjithë kjo zonë është e përfshirë në portin e ri turistik të Durrësit”, shtoi ai.

“Ne kemi marrë javën e

ballemi me gjëra që janë absolutisht të rënda, të padëshiruara, nuk i kemi zgjedhur ne, por na zgjodhën në formën e sfidave kulmore, që nga tërmeti që Durrësin e goditi egërsisht, pastaj pandemia, tani një luftë e cila nuk ka ardhur në Shqipëri me bomba por ka ardhur me infla-



shkuar edhe dokumentet e fundit për të plotësuar dosjen e plotë për gjithë procesin e kalimit të procedurës në qeveri dhe në Parlament dhe për të filluar punën dhe puna do të fillojë në dy ekstremet, në ekstremin lindor dhe këtu në ekstremin perëndimor. Falë atij investimi, ju do jeni ku e ku më mirë sesa sot për të vazhduar normal aktivitetin tuaj. Ky është porti juaj, këtë nuk e prek njeri, por në pjesën ku sot ka gjithë ato mure betoni, ku ka gjithë ato hekurishte, do të ketë një bulevard turistik dhe të kombinuar kjo edhe me ardhjen e trageteve të pasagjerëve nga ana tjetër, do plotësohet më së miri kjo panoramë”, tha kryeministri.

E njëjta gjë, sipas tij, “vlen edhe për portin e peshkimit në Vlorë, që do jetë i standardeve europiane dhe ai dhe që do jetë pjesë e kompleksit të Triporit, ku po punohet intensivisht për portin e ri tregtar të Vlorës”.

“Besoj që i kemi të gjitha mundësitë të vazhdojmë këtë transformim dhe nëse sot ne na duket se kemi bërë shumë në raport me ku e nisëm, duhet të bëjmë çmos që në raport me sot aty ku do të arrijmë të jetë njësoj shumë. Është një dekadë shumë e rëndësishme për Shqipërinë, na ka qëlluar që të për-

cionin e saj”, tha ai.

Kryeministri u shpreh se këto rritje çmimesh nuk i ka sjellë qeveria dhe qeveria nuk i zhbën dot.

“Nuk ka qeveri që t’i zhbëjë, por që qeveria ka detyrë t’i lehtësojë duke rritur mbështetjen financiare për të gjitha kategoritë që kanë nevojë për mbështetje dhe kur them që kanë nevojë për mbështetje nuk kam parasysh vetëm ata më të dobët, por edhe ata që janë në mes, të gjithë ata që punojnë në sektorë të ndryshëm të shërbimeve, të gjithë ata që janë të angazhuar me mbrojtjen, që janë të angazhuar me rendin publik, të gjithë ata që janë të angazhuar me arsimin, që janë të angazhuar me gjithë strukturën e jashtëzakonshme në aspektin e punësimit dhe të ekonomisë së vogël familjare që është biznesi i vogël, pa diskutim pensionistët, pa diskutim nënat kryefamiljare me dy fëmijë, me tre fëmijë, që janë me ndihmë ekonomike, të moshuarit mbi 65 vjeç që janë me ndihmë ekonomike. Të gjithë këta kanë nevojë për ekstra. Ajo që ne praktikisht po bëjmë është pikërisht kjo, të shtojmë sa të mundemi pagat e tyre, të shtojmë sa të mundemi ndihmën për ta, të shtojmë sa të mundemi pensionet e tyre”, tha ai.

Krifca: Regjistri i Fermës, garanci për sigurinë ushqimore

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca deklaroi sot se në Raportin e Progresit për vitin 2022, i cili iu dorëzua qeverisë shqiptare një ditë më parë, vlerësohet ecuria në disa sektorë të bujqësisë.

Deklarata e ministres Krifca u bë gjatë vizitës së saj në Dublin, Irlandë, ku po zhvillon takime me autoritetet më të larta të Komisionit Evropian për Shëndetin dhe Sigurinë Ushqimore, si dhe me autoritetet e Republikës së Irlandës.

“Progresraporti evidentoi një mori punësh të kryera nga Ministria e Bujqësisë gjatë vitit 2022, ku ne kemi mundur në Kapitullin e 11 një punë të mirë të bërë me bazat e hedhura për Regjistrin e Fermës, ku deri më sot numërohen rreth 82.000 fermerë të regjistruar me kod unik ferme. Kjo na garanton më pas edhe një siguri ushqimore më të mirë nga ferma në tryezë”, tha Krifca.

Ministrja theksoi se është bërë një punë e mirë edhe me zbatimin e Programit IPARD II, me përthithjen e fondeve, ndërkohë informoi se është

miratuar Programi IPARD III, me rreth 54% më shumë fonde në dispozicion të Programit IPARD III, i cili do të përmbajë kësaj radhe 9 masa, përtej 3 masave që ishin të akredituara deri më tani.

“Është një punë voluminoze që kryhet nga strukturat. Natyrisht që më erdhi mirë të konstatoja që dhe në Kapitullin 13, sa i takon “Peshkimin”, ne kemi nota pozitive, që kanë të bëjnë me investimet e kryera në flotën e peshkimit, por gjithashtu edhe me marrëdhëniet ndërkombëtare, ku ne jemi pjesë anëtare e mekanizmave më të larta të Komisioneve të Peshkimit në botë. Dhe arsyeja e vizitës time në Irlandë ka të bëjë pikërisht me ndjekjen e praktikave më të mira, me adoptimin e rregulloreve të Bashkimit Evropian, për sa i takon sigurisë ushqimore, planeve të monitorimit të mbetjeve dhe kontrolleve zyrtare”, u shpreh Krifca.

Sipas saj, strukturat e MBZHR po avancojnë në axhendën për Kapitullin 12, që është “Siguria Ushqimore”.

“MBZHR po ndjek praktikat më të mira, me adoptimin e rregulloreve të Bashkimit Evropian, për sa i takon sigurisë ushqimore, planeve të monitorimit të mbetjeve dhe kontrolleve zyrtare. Rruga e përputhshmërisë me standardet e Bashkimit Evropian për bujqësinë, për peshkimin, për sigurinë ushqimore është e vetmja rrugë drejt zhvillimit ekonomik të qenësishëm për familjet fermere, për peshkatarët, të cilët duke respektuar standardet e Bashkimit Evropian për sigurinë ushqimore e kanë të mundur që të shesin më shtrenjtë në tregje të sofistikuar dhe të krijojnë një ekonomi më të mirë për vendin tonë”, tha ajo.

Ky rrugëtim, tha ajo, i ka çuar ata drejt faktit që sot eksportojnë rreth 15 miliardë euro produkte ushqimore në vendet më të zhvilluara të Evropës, duke qenë kështu eksportues neto.

“Shqipëria me ambicet që ka për eksportet bujqësore do të ndjekë këtë rrugë”, deklaroi Krifca.

AZHBR vijon përgatitjet intensive për akreditimin e programit IPARD III

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, (AZHBR) vijon përgatitjet intensive për akreditimin e Programit IPARD III.

Drejtoresha e AZHBR-së, Eranda Selmanaj, tha se sot

e Përgjithshme për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural), në Komisionin Europian, me pjesëmarrjen e vendeve zbatuese të Programit IPARD, AZHBR prezanton arritjet dhe ndryshimet e parashikuara për

e zbatimit të Programit IPARD II, ku AZHBR ka ecur me hapa të shpejtë dhe të kënaqshme në përthithjen dhe disbursimin e fondeve sipas parashikimeve të Programit.

Gjithashtu, krijimi i sistemit të aplikimeve online për Programin IPARD III, si një risi që ofron lehtësi për aplikantët, rrit transparencën dhe shmag barrierat administrative.

“Të njëjtat arritje janë konfirmuar edhe në Raport Progresin për Shqipërinë, publikuar nga Komisioni Europian për periudhën Shtator 2021 – Shtator 2022, për punën e bërë në një vit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, veçanërisht në rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve për miratimin e Programit IPARD III si dhe zbatimin e suksesshëm të Programit IPARD II”, tha Selmanaj.



në takimin online të organizuar nga Dg-Agri (Drejtorja

Programin IPARD III. Në takim u përgëzua ecuria

Festa e mollës në Korçë, fermerët e Dvoranit festojnë vjeljen

Qarku i Korçës, një prej prodhuesve më të mëdhenj të mollës në vend, për të disatin vit radhazi ka organizuar pasditen e së shtunës festën e mollës.

Kryetari i bashkisë Korçë, Sotiraq Filo, publikoi në rrjetet sociale foto nga aktiviteti i organizuar, për festën e mollës, teksa tha se, “sollëm edhe këtë vit “Festën e Mollës” në fshatin Dvoran me qëllim promovimin e një prej produkteve tona më të njohura”.

Panairi me varietete mollësh të zonës së Korçës, lojërat për fëmijët dhe muzika argëtuan

pjesëmarrësit e shumtë.

Pjesë e festës këtë vit u bënë edhe 16 fermerë e specialistë të rinj të frutave, të cilët u certifikuan nga GIZ për pjesëmarrje në trajnimin “Mbi kontrollin biologjik të krimbit dhe kromës së mollës”, në kuadër të programit SRD/GIZ Albania.



Molla e Korçës, mbetet e pakonkurrueshme në cilësi e shije ndaj dhe fermerët prodhues të këtij fruti synojnë zgjerimin e tregjeve të shitjes.

Fermerët e rajonit të Korçës prodhojnë rreth 100 mijë tonë mollë në vit dhe mbi 40% e këtij prodhimi ruhet në kushte frigoriferike.

Eventi bëri bashkë vizitorë e familjarë të cilët bashkërisht ndihmuan fermerët në vjeljen e mollëve. Festa vijoi deri në orët e vona të mbrëmjes nën tingujt e muzikës, kërcimit dhe degustimit të ushqimeve tradicionale të zonës.

“Mbjellim limon, se do pak punë” - Fermeri në Fier ndryshon kulturën bujqësore prej kostove të larta

Fermeri Olti Duda provon gjithnjë të ndërrojë kulturat që kultivon në serrat e tij në fshatin Frashër në Fier për t’iu përshatur krizave.

Pas luleshtrydheve që ishin prova e tij e parë pasi braktisi profesionin si ekonomist, Olti provoi të mbillte limonin në serrë për shkak të pakësimit të krahut të punës. Limoni do më pak punë se perimet.

“Rendimentin menduam se do ta kishim të lartë por ka

shumë lagështi klima jonë. Tani do t’i nxjerrim në vazo.”- tha fermeri Olti Duda.

Po për shkak të pakësimit të krahut të punës ai kishte provuar të mbillte dhe rrushin në serra.

“Kemi një rast këtu në fshat. Ikën në secili familjarisht morën serra me qira. Ka kushte më të mira atje”- tha ai.

Me heqjen e 20% të TVSH fermeri thotë se vështirësitë u janë shtuar nga ana e pikave të

grumbullimit

“Pika e grumbullimit më thotë: nëse malli prishet nuk ta paguaj. jemi në kushte më të vështira tani me këtë luftën. subvencionin nuk mbulon as koston e fidanit”- tha Duda.

Tani në Frashër vetëm tre serra shfrytëzohen, të tjerat janë lënë bosh. ndërsa banorët largohen Oltit që të vazhdojë punën i ka mbetur vetëm të kërkojë të huaj për të punuar në vend të tyre

Të ndihmojmë fermerët në disa fronte kryesore të vjeshtës

Nga: Haziz Sava, Kryetari i B.K.F.SH

Vjeshta është periudha që fermeri përballë me shumë fronte pune, por për momentin po trajtojmë 3 nga këto probleme:

1. Kullimi, ujitja dhe mbrojtja nga erozioni nga përmbytja e tokës.

2. Mbjellja e grurit dhe e kulturave të tjera të vjeshtës.

3. Sigurimi e ruajtja e bazës ushqimore dhe strehimi i blegtorisë.

Problemi i ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes së erozionit nga përmbytja është kryesore në këtë periudhë. Për këtë vit jemi shumë të vonuar pasi ky problem duhet të fillonte që në muajin korrik e derisa të na lejonin kushtet.

Bashkimi Kombëtar i Fermerëve Shqiptarë (B.K.F.SH) i ka propozuar kryeministrit Z. Edi Rama, që në korrik të vitit 2017, që të bëhet aksion kombëtar për kullimin, ujitjen dhe mbrojtjen nga erozioni e përmbytja, nga muaji korrik deri në fund të dhjetorit. Për këtë të përqendrohen mjetet që nga ekskavatorët krahëgjatë, krahëshkurtër e fadroma, në çdo bashki ose përqendrim mjetesh në zonat të cilat janë problematike.

Ky propozim u bë pasi qeveria bëri një punë të mirë në vitin 2017, duke siguruar 61 ekskavatorë krahëgjatë për bashkitë dhe 10 ekskavatorë krahëgjatë për bordet e kullimit në 4 qarqet e vendit.

SI ËSHTË GJENDJA DERI TANI?

I. Për kullimin:

Në shkallë vendi janë 280'000 Ha tokë që duhen kulluar rregullisht çdo vit. Për të realizuar këtë duhet të zhvendosen 8'000'000 m³ dhera. Po të shfrytëzohen mirë këto mjetet që disponohen, Shqipëria kullohet mirë çdo vit plotësisht.

Aksioni pati më shumë sukses, në vitin 2018 ku morën pjesë 39 ekskavatorë krahëgjatë, dhe 18 fadroma, ku kullohen në shkallë vendi 450 km kanale kulluese, dhe u pastruan 129 km kanale vaditëse, u ndërjuan 32 km argjinatura, në lumet dhe përrenjtë malorë. Ndërsa në vitet 2019, 2020, 2021 pati rënie, për shkak të tërmetit dhe pandemisë, megjithatë gjatë vitit 2020, punuan 23 krahëgjatë, dhe 26 krahëshkurtër, dhe në vitin 2021 punuan 29 ekskavatorë krahëgjatë dhe 21 ekskavatorë krahëshkurtër, por volume i punës ka qenë shumë i vogël.

Për këtë vit 2022 megjithëse u fillua me vonesë nga bashkitë, B.K.F.SH është munduar të nxisë këtë aksion, duke dërguar nga një letër, të gjithë Bashkive të zonave bujqësore për të ndihmuar që të merren masat për ta realizuar me sukses.

Shumë bashki kanë komunikuar me ne, duke vlerësuar problemin që ngrinin ne në letër. Bashkia e parë që na komunikoi me shtabin e B.K.F.SH ka qenë kryetari i Bashkisë Lezhës Z. Pjerin Ndreu. i cili ka organizuar shumë mirë punën duke organizuar 7 mjetet ekskavatorë

e fadroma dhe pretendon për kullimin e pastrimin e kanaleve ujitëse në 160 km.

Mirë ka filluar punën dhe Bashkia Shkodër, me 6 mjetet ekskavatorë, Bashkia e Vaut të Dejës me 4 mjetet. Në këto 3 bashki punojnë 4 ekskavatorë të bordeve të kullimit, për kanalet ujë-mbledhëse dhe kanalet e para. Vlen të theksojmë se krahas punës së drejtuesve të Bashkisë të sipërme, mjaft mirë ka punuar përfaqësuesi i B.K.F.SH në këto bashki Z. Zek Deda, i cili ka mbajtur kontakt të rregullt me kryetarët e këtyre Bashkisë. Mirë po punon dhe Bashkia e Durrësit i cili ka vënë në punë 3 ekskavatorë krahëgjatë. Në Bashkinë e Kavajës, punohet mirë me 1 ekskavatorë krahëgjatë dhe 1 të bordit të kullimit. Në Rogozhinë po punohet me ekskavatorë krahëshkurtër. Në Bashkinë e Kavajës dhe Rogozhinës po punon mirë përfaqësuesi i B.K.F.SH Z. Rustem Thartori, që është dhe sekretari i përgjithshëm i B.K.F.SH. Në Dibër po punon mirë përfaqësuesi i B.K.F.SH Z. Nazmi Drizi. Në zonën Fier dhe Lushnje, po punohet mirë me kullimin, ku në Fier punojnë 5 ekskavatorë të Bashkisë dhe 2 të Bordit të Kullimit. Në Lushnje po punojnë 3 ekskavatorë. Krahas punës së mirë të këtyre drejtuesve të këtyre Bashkisë, le të përmendim dhe punën mjaft të mirë të Z. Nesti Zoit si përfaqësuesi i B.K.F.SH.

Në Vlorë, punojnë 3 ekskavatorë të Bashkisë dhe 1 Ekskavatorë i Bordit të Kullimit, edhe kjo bashki e ka kapur mirë punën vlen të përmendim preokupimin serioz të Zv. Kryetares së Bashkisë Znj. Aulona Gashi e cila ka komunikuar vazhdimisht me Shtabin e B.K.F.SH. Mjaft mirë po punon dhe përfaqësuesi i B.K.F.SH Z. Ilirjan Mezin i ngarkuar për Bashkinë e Vlorës.

Në Berat punë të mirë po bën Bashkia Dimal, kanë në punë 2 ekskavatorë të Bashkisë dhe 1 të Bordit të Kullimit. Sipas përfaqësuesve të Bashkisë dhe Drejtorisë së Bujqësisë Dimal po punohet mirë për mbrojtjen nga përmbytjet e 450 Ha toke. Kjo bashki ka nevojë për 1 ekskavatorë për kullimin dhe 1 ekskavatorë të Bordit të Kullimit. Koordinuam me Znj Fatime Plaku si përfaqësuese e B.K.F.SH në Bashkinë Dimal.

Në Korçë, Bashkia ka 2 ekskavatorë, dhe 1 të bordit të Kullimit, Bashkia Devoll ka 1 ekskavator, Bashkia Maliq ka 3 ekskavator dhe 1 të bordit të kullimit. Në Maliq është punuar shumë mirë, si nga Bashkia dhe nga ndihma e Ministrisë së Bujqësisë, ku kanë mbrojtur nga përmbytja 3500 Ha tokë për këtë vit 2022. Për të ndihmuar në këtë bashki ka dhënë kontributin mjaft të mirë dhe përfaqësuesi dhe nënkryetar i B.K.F.SH Z. Fredi Fellahu i cili ka koordinuar mjaft mirë me

drejtuesit e këtyre 3 Bashkisë. Sipas të dhënave punë të mirë ka dhe në Bashkinë e Pogradecit në të cilën kemi koordinuar. Mirë është punuar dhe në Bashkinë Elbasan Gramsh, Gjirokastrë, Mat, Tiranë, Kukës, Sarandë, Delvinë, ku në një pjesë të këtyre nuk kemi përfaqësues të B.K.F.SH dhe presim të na sjellin informacion në numrin e celularit tonë që kemi dërguar në letër, që kanë arritur nga ana jonë në këtë bashki.

Këto të dhëna janë deri tani pasi mund të ndryshojnë mjetet sipas nevojës që kanë bashki dhe Bordet e kullimit. Punë e mirë është bërë deri tani dhe në Bashkinë e Durrësit dhe kryesisht dallohet njësitë Administrative Sukth i Ri për një punë të mirë si nga Administratori Edlir Cerri, dhe Inxhinieri i njësisë Xhevahir Çausi, dhe kryeplaku i fshatit Vadarhtë të kësaj njësie Z. Qemal Doda. i cili megjithëse drejton një fshat me 6 lagje, me afro 10'000 banorë, ka qëndruar vazhdimisht pranë ekskavatorit të sjellë nga Bashkia Durrës, ky person ka bërë një punë mjaft të mirë për njësinë dhe do të vazhdojë me ekskavatorë dhe në fshatrat tjerë të kësaj njësie. Më le të falenderoj dhe punën mjaft të mirë në sasi dhe cilësi të ekskavatoritit Gjovalin Marku i cili ka bërë punë me shumë cilësi. Kjo njësi ka nevojë për një ekskavator krahëgjatë të Bordit të Kullimit për të pastruar kanal in ujëmbledhës, të Tonës i cili mbledh ujërat e gjithë kanaleve që derdhen në të. Mos pastrimi i tij nxjerr jashtë përdorimit dhe kanalet e pastruara. Sukthi është një njësi administrative i cili po shkon afro 40'000 banorë. Ndërhyrja këtu është e domosdoshme, dhe ndërtimin e bankinës për lumin Erzen, për t'u mbrojtur nga përmbytjet.

Krahas anëve të mira, në këtë aksion vërehen dhe të meta të cilat duhen riparuar pa vonesë. Së pari nuk është i njëjti preokupim si i disa Bashkisë si në ndjekjen e aksionit, në planifikimin e punës dhe kontrollin e mjeteve për secilën ditë. Nuk kanë një person që t'i qendrojë pranë çdo kohë ekskavatorit ta drejtojë ku dhe si do të punojë, ta ndihmojë për ushqim, ujë dhe furnizim me karburant. Dhe të lëvizë në bazë të një grafiku të caktuar. Ka pasur raste, që në disa bashki nuk sigurohen makina për transportimin e materialit gjatë kullimit në zonat e Banuara, ky problem duhet të merret parasysh.

Nga Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë dhe ato të Bashkisë kërkohet me përpjekje e përqendrim në ndjekje të këtij problemi, po kështu nga nënkryetarët e Bujqësisë e Bashkisë kërkohet që të trajtojnë mirë dhe pa ndërprerje punën në këtë drjetim. i bëjmë thirrje drejtorive të Bordit të Kullimit të ndjekin me përgjegjësi lëvizjen e mjeteve sipas nevojës në Bashkitë përkatëse. Vlerësim

kërkojmë më shumë dhe nga Qeveria sidomos në shtimin e investimeve. i jemi mirënjohës Zv.Ministrit të Bujqësisë Z.Dhimo Kote, për ndihmën që ka dhënë, sidomos me organizimin dhe drejtimin e bordeve të kullimit.

II. Për ujitjen:

Problemi i ujitjes është shqetësues në shkallë kombëtare, nga 400'000 Ha tokë që ka qenë aftësia ujitëse në Vitin 1990 sot, as 50 % nuk është kjo aftësi. Nuk na vjen mirë që të jetë kjo gjendje, në një kohë që Shqipëria është 1 ndër vendet në botë me rezerva më të mëdha uji. Në Shqipëri janë 247 liqene të ndryshme me sipërfaqe 1'210 km² me një rezervë ujore 60 miliardë m³ ujë. Ka patur 670 rezervuarë uji si dhe 200 burime nëntokësore me 200 lit ujë/sekondë. Çdo vit derdhen në det nga lumenjtë 39 miliardë m³ ujë.

SI ËSHTË GJENDJA SOT?

Nga 670 rezervuarë sipas të dhënave të aksionit 2018 vetëm 120 janë në gjendje pune, shumica është shkatërruar, dhe një pjesë janë bllokuar me riprodhimin e peshqve. Më mirë me rezervuarët ka punuar Korça, që nga 8 rezervuarë ka në gjendje pune 8. Mirë ka punuar dhe Bashkia Dimal (Berat) që nga 9 rezervuarë janë në gjendje 9. Kërkojmë nga qeveria dhe Bashkitë që të bëhet një kontroll për të gjithë rezervuarët në shkallë vendi. Të përcaktohen masat dhe investimet për rregullimin e tyre. Të bëhet pastrimi i kanaleve vaditëse nga rezervuari deri në parcelë. Është fatkeqësi që nga të gjithë kanalet vaditëse që kanë qenë hapur në Dibër siç ka qenë kanali Sete-Reç që ka pas mbuluar 4 njësi administrative. Kanalet në Mat e Mirditë, Shkodër, Krujë, Durrës, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Elbasan, Korçë etj. Kanë nevojë për riparime të forta, dhe pastrime pasi shumica janë shkatërruar e duan shumë investime. Për një punë më të mirë për kanalet kulluese, mund të përmendim Bashkinë e Fierit, Lushnjes, Vlorës, Beratit, Korçës, që kanë treguar një interes më të mirë në mirëmbajtjen dhe funksionimin e këtyre Kanaleve. Shumë mirë ka punuar Bashkia Dimal, ku ka stacion pompimi me 1000 litra/sekondë që përballon 4 fshatra përveç 9 rezervuarëve që i shfrytëzojnë plotësisht për ujitje. Mirë po punon dhe Bashkia Dibër sidomos në hapjen e kanaleve të reja ku deri tani është hapur kanali 1700 ml për fshatin Kishavec të njësisë Administrative Kastriot. Ky kanal është betonuar komplet. Kërkojmë një kontroll të fortë në investime në pastrimin e plotë të kanaleve vaditëse brenda këtij aksioni (brenda Vitit 2022).

III. Mbrojtja nga përmbytjet, erozioni

Përmbytja, problem shumë i madh veçanërisht për zonën Shkodër-Lezhë-Kurbini-Fush Krujë-Durrës- Kavajë- Vlorë – Berat- Elbasan- Korçë- Dibër – Mat – Pogradec etj. Banorët e këtyre të zonave janë në tension kur bie shi, ku shpeshherë përmbytjen tokat, dëmtohen bimët, blegtorija, banesat e bllokohen rrugët. Përmbytjet ndodhin për 3 arsye. 1 Për mungesë të argjinaturave për mbrojtjen nga vërshimet e lumenjve si të 8 lumenjve të mëdhenj, e përrenjëve malorë. Është për të ardhur keq që ka 650 argjinatura. Shumica janë ndërtuar para 50 vjetësh, ku 25 vjet ka që kanë skaduar, Argjinatura të reja ka që janë ndërtuar një pjesë për vitin 2014-2018 ku vetëm për vitin e 2018 u ndërtuan sa 32 km argjinatura të reja. Në argjinaturat e tjera ka pasur shumë pak riparime. Në Dibër vlen të përmendet puna e mirë, e ngritjes së argjinaturës në vitin 2021, për mbrojtjen nga Drini i Zi, ku u mbrojtën 30 Ha në Zall-Sine. Mendojmë të propozojmë që argjinaturat të ndiqen me shumë kujdes në të gjithë lumenjtë dhe të planifikohen nga Qeveria Investimet e nevojshme.

Nga hapja pa kriter e digave të hidrocentraleve dhe liqeneve, duke u përmbetur çdo vit, Shkodër dhe Lezhë nga hidrocentralet e zonës së veriut. Shijak, Sukth i Ri nga hapja pa kriter e portave të liqenit të Farkës. Në Dibër nga shkrumbini, Zonat e Vlorës dhe zonat e tjera nga lumenjtë e medhenj. Për këto duhen argjinatura e prita në digat e forta pa humbur kohë. E domosdoshme dhe shumë shpejt është ndërtimi i bankinës për mbrojtjen nga lumi Erzen në njësinë administrative Sukth i Ri ku shpëton zonën nga Sukth i Ri 6 lagjet e fshatit Vadarë dhe fshatin Krushkull nga përmbytjet e lumit Erzen i cili çdo vit ka bërë dëme serioze.

Nga mos riparimi i hidrovoreve dhe mungesa e hidrovoreve të rinj, si në Maliq e ndonjë vend tjetër krijohen përmbytje shumë të mëdha. Ky problem të vlerësohet sa më shpejt dhe të bëhen riparimet e nevojshme dhe ndërtimi i hidrovorit të ri në Maliq të Korçës. Nga përmbytjet ndikojnë dhe mos kullimi i mirë dhe në kohë i kanaleve kulluese.

Dëme të mëdha ka sjellë dhe erozioni, si në zonat kodrinore ashtu dhe në shfrytëzimin pa kriter të inerteve të lumenjve. Mendojmë që të ndalohet me ligj shfrytëzimi jo i rregullt i inerteve dhe dëmtimi i bimëve mbrojtëse, të plepave etj. që vendosen pranë përrenjëve e lumenjve. Si edhe të bëhen mbjelljet e reja gjatë muajve nëntor-dhjetor. Për 3 problemet e aksionit si kullim, ujitje dhe mbrojtje nga erozioni dhe përmbytja kërkohet ta marrim seri-

ozisht Bashkitë, njësitë administrative, drejtorinë Rajonale të Bujqësisë dhe ato të bashkisë, bordet e kullimit, drejtorinë e kanalizimeve dhe ujitjeve dhe deri tek Ministria e Bujqësisë dhe Qeveria. Mundësisht kërkohet që për këtë aksion, të na informojnë bashkitë që kemi dërguar letrat nga B.K.F.SH në celularin e shkruar në letrën e dërguar nga ana jonë. Për këtë kërkohet ndonjë informacion sa mjetet kanë marrë pjesë në kullim, sa km kanale kulluese janë bërë, sa pastrim kanale ujitëse janë bërë, sa prita të reja dhe riparime janë bërë dhe sa pompa kanë funksionuar për ngritjen mekanike për ujitje. Këto mundësisht brenda 25 dhjetor 2022, mundësisht dhe gjenden e rezervuarëve për ujitje.

MBJELLJA E GRURIT DHE KULTURAVE TË TJERA TË VJESHTËS

Periudha e muajit tetor për zonat e veriut dhe nëntor për Shqipërinë e mesme dhe të jugut. Janë kushtet optimale për mbjelljen e kulturës së grurit. Shqipëria para viteve 90' ka pasë mbjellë 180-200 mijë Ha grurë. Ndërsa në vitin 2021 ka mbjellë vetëm 53 mijë Ha. Shumica e grurit importohet nga jashtë rreth 250 ton/ha në vit. Vetëm për 8 mujorin e parë të këtij viti, janë importuar 102.5 mijë Ton grurë. Nga kjo del që është e domosdoshme rritja dhe mbjellja e grurit duke shfrytëzuar tokat djerrë e të pambjella deri tani. Vendimi i marrë nga qeveria mbi subvencionin e fermerit mbi 1 Ha me 30'000 lekë të reja/ Ha është një ndihmë e madhe për fermerin, por mendojmë se ky vendim të mos u ishte dhënë kushti që fermeri të ketë patjetër NIPT pasi ka dhe fermerë, që mund të marrin tokë me qera për 1 vit apo më shumë, dhe nuk kanë mundësi të përballojnë kostot financiare të pagesave të qerave dhe taksave. Kjo kategori fermerësh, që mund të jenë shumë pengon mbjelljen e shumë sipërfaqeve të grurit dhe nuk shfrytëzohen tokat djerrë që këto janë me shumicë në shkallë kombëtare. Ne nuk jemi që të bllokojmë NIPT, të shikohet mundësia për NIPT por të gjendet një rrugë e mesme për sa i takon kostove financiare të taksave, për këtë kategori të fermerëve që nuk kanë mundësi të tilla. Kërkojmë që të rishikohet dhënia e naftës pa akcizë pasi, nga 50'000 fermerë që kanë aplikuar del para ca kohësh që vetëm 26'000 kanë përfituar. Ky veprim bën një pengesë serioze në mos-mbjelljejn e grurit. Lutemi që të rishikohet dhe të ndiqen kërkesat e fermerëve dhe ato të plotësohen në kohë, për të mos u bërë pengesë për realizimin e mbjelljes. Një pengesë për mos realizimin e mbjelljeve është dhe mungesa e mekanizimit, kjo sidomos për zonat e thella.



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



**MBËSHTETJE FINANCIARE
PËR TË GJITHË FERMERËT**

**KREDI E DEDIKUAR
PËR MBJELLJEN E GRURIT**



Dita Botërore e Ushqimit, FAO thirrje për të ndihmuar fermerët e vegjël në zonat rurale

Festimet me rastin e Ditës Botërore të Ushqimit 2022, u mbajtën në Romë nën thirrjen mobilizuese “Askush të mos mbetet pas”, mes një krize globale të përkeqësimit të sigurisë ushqimore dhe numrit më të lartë të të gjitha kohërave të njerëzve në rrezik dhe përjetimit të niveleve serioze të urisë në Azi dhe Afrikë.

Ngjarja vjetore përkujton themelimin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO) në vitin 1945. Në një ceremoni globale, zhvilluar në selinë e FAO-s në Romë, u përçuan mesazhe të rëndësishme, ndër të tjera, nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së Antonio Guterres, Papa Françesku dhe presidenti italian Sergio Mattarella.

Edicioni i këtij viti zhvillohet në një kohë kur siguria globale e ushqimit po përballë me kërcënime të shumta, me rritjen e çmimeve të ushqimit, energjisë dhe plehrave që i shtohen ndikuesve tradicionalë si

ndryshimet klimatike dhe konfliktet e gjata.

“Përballë një krize globale të ushqimit që po afrohet, ne duhet të shfrytëzojmë fuqinë e solidaritetit dhe momentum kolektiv për të ndërtuar një të ardhme më të mirë ku të gjithë kanë akses të rregullt në ushqim të mjaftueshëm me vlera ushqyese”, tha Drejtori i Përgjithshëm i FAO-s QU Dongyu në fjalimin e tij drejtuar ceremonisë në Romë.


Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së Antonio Guterres vuri në dukje se Dita Botërore e Ushqimit 2022 po zhvillohej në një moment sfidues për sigurinë globale të ushqimit dhe u bëri thirrje palëve të interesuara të vepronë së bashku në mënyrë që të kalojnë nga dëshpërimi në shpresë dhe veprim.

“Këtë vit, më shumë se kurrë, Dita Botërore e Ush-

qimit duhet të jetë një thirrje për të rritur veprimet për të ndihmuar fermerët e vegjël në zonat rurale, të cilët furnizojnë ushqim për komunitetet dhe vendet e tyre, nga kriza në krizë pavarësisht pabarazisë, cenueshmërisë dhe varfërisë”, tha Alvaro Lario, President i Fondit Ndërkombëtar të OKB-së për Zhvillimin Bujqësor (IFAD).

Ngjarjet e pasdites në Romë përfshijnë inaugurimin e një ekspozite me foto nga hapësira që evidenton efektet e ndryshimeve klimatike, të marra nga astronauti i Agjencisë Evropiane të Hapësirës dhe Ambasadori i Vullnetit të Mirë të FAO-s, Thomas Pesquet.

Ndërsa në edicionin e dytë të Forumit Botëror të Ushqimit, diskutohet për sigurinë ushqimore për të arritur një të ardhme më të mirë ushqimore për të gjithë,



ku askush nuk mbetet pas.

“Duhet bërë më shumë për të ndihmuar fermerat në shkallë të vogël, të cilat prodhojnë më shumë se një të tretën e ushqimit në botë, por që përfaqësojnë 80 për qind të prodhuesve botërorë. Ato janë një nga themelet e sistemeve agroushqimore të botës, megjithatë janë shumë shpesh të bllokuar në ciklet e varfërisë dhe pasigurisë ushqimore dhe të përjashtuar nga mundësitë në sistemet e dominuar nga prodhuesit dhe shitësit e mëdhenj. Kjo kërkon transformimin e sistemeve aktuale agroushqimore për të ofruar mundësi të barabarta për të gjithë prodhuesit dhe për të ndihmuar pronarët e vegjël të kenë akses në tregje të reja”, thuhet në njoftimin e publikuar nga FAO, teksa theksohet se, qeveritë duhet të ndërmarin një zotim për të mos lënë askënd prapa në strategjitë, planet dhe buxhetet e tyre për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, të OKB-së.

OPINION

Në Ditën Botërore të Ushqimit, le të forcojmë vendosmërinë tonë për të punuar së bashku në mënyrë që askush të mos mbetet pas

Nga: Vladimir Olegovich Rakhmanin
Ndhmës Drejtori i Përgjithshëm i FAO-s dhe Përfaqësues
Rajonal për Evropën dhe Azinë Qendrore



Çdo vit më 16 tetor, kremtimi i Ditës Botërore të Ushqimit udhëhiqet nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO). Është një ditë për të reflektuar se çfarë mund të bëjmë, kolektivisht, për t'i dhënë fund urisë. Është një ditë që të nxit të punojmë për 3.1 miliardë njerëz në mbarë botën që nuk mund të përballojnë një dietë të shëndetshme dhe 828 milionë njerëz që shkojnë në shtrat të uritur çdo ditë. Është një ditë për të vendosur se çfarë mund të bëhet për t'i dhënë fund urisë dhe kequshqyerjes që po çon në humbje jete, dhe duke vënë në rrezik një të ardhme të shëndetshme për fëmijët tanë – globalisht, si dhe në Evropë dhe Azinë Qendrore.

Megjithëse kemi bërë përparim drejt ndërtimit të një bote më të mirë, progresi është ngadalësuar kohët e fundit. Bota është përballur me shumë kriza globale në dy vitet e fundit, të cilat rezultuan me shumë njerëz të mbetur pas. Pandemia e COVID-19, ngjarjet ekstreme të motit që pengojnë prodhimin e ushqimit, rritja e çmimeve të ushqimit dhe energjisë dhe konfliktet kanë prekur edhe rajonin tonë. Uria dhe kequshqyerja po rriten dhe më shumë njerëz po bien në varfëri. Është koha, tani më shumë se kurrë, që ne të punojmë së bashku për të ndërtuar një epokë të re shprese, për të gjithë, kudo.

Ne duhet të ndërmarrim veprime për të siguruar që të gjithë të kenë akses në ushqim të sigurt, të përballueshëm dhe me vlera ushqyese në çdo kohë. Por ne duhet të vepronë së bashku. Ndryshimi

i qëndrueshëm mund të vijë vetëm nga veprimi kolektiv i bashkërenduar dhe i vendosur. Një ndryshim i rëndësishëm dhe i përhapur që po udhëheq FAO është ai i transformimit të sistemeve ushqimore dhe lehtësisë të aksesit dhe integritetit në treg. Kjo iniciativë do të nxisë transformimin e sistemeve ushqimore që të jenë më efikase, më gjithëpërfshirëse, më elastike dhe më të qëndrueshme, për prodhim më të mirë, ushqim më të mirë, një mjedis më të mirë dhe një jetë më të mirë për të gjithë. Sistemet tona agroushqimore kanë potencial të madh për një të ardhme më të barabartë dhe më të begatë, pasi ato janë të

ndërlidhura me shumë fusha të jetës dhe ekonomisë sonë – duke përmendur disa, nga bujqësia te burimet natyrore, te energjia, te shëndeti.

Në Evropë dhe Azinë Qendrore, zhvillimi i qëndrueshëm i sistemeve agroushqimore ndikohet nga tranzicionet socio-politike që po ndodhin. Në rajon, FAO po mbështet zhvillimin e politikave tregtare kombëtare dhe rajonale për të krijuar sisteme më të qëndrueshme agroushqimore.

Por për të arritur këtë qëllim ne duhet të vepronë si një shoqëri globale. Ne duhet të mbështesim vendet në rrezik të urisë, kequshqyerjes dhe urisë, duke i ndihmuar ata të trans-

formojnë sistemet agroushqimore, duke financuar thirrjet humanitare dhe duke rritur rezistencën. Prioritet më i madh duhet t'i jepet rritjes së prodhimit vendas të ushqimit me vlera ushqyese, ruajtjes së burimeve natyrore dhe vlerësimit të traditave lokale, tokës dhe agroekosistemeve të rëndësishme kulturore të mbajtura nga fermerët tradicionalisht.

Së bashku, ne duhet të fuqizojmë më të rrezikuarit, përfshirë prodhuesit e vegjël, duke investuar në sistemet agroushqimore. Kjo do të thotë gjetja e mënyrave për të ofruar akses të përmirësuar në trajnime, stimuj,

shkencë, të dhëna, teknologji dhe inovacion, duke i vendosur pronarët e vegjël në qendër të këtij transformimi. Inovacioni dhe dixhitalizimi i bujqësisë mund të përshpejtojë arritjen e një jetese më të mirë për fermerët e vegjël, duke u dhënë atyre akses në informacione të rëndësishme lokale, të tilla si moti, kushtet e tokës, ujitja, rikuperimi me siguri pas ngjarjeve të tilla si përmblytjet, çmimet e tregut lokal për të mbjellat dhe kontrolli i dëmtuesve. Në Evropë dhe Azinë Qendrore nën iniciativën rajonale për të fuqizuar pronarët e vegjël, fermat familjare dhe të rinjtë, FAO po

mbështet zhvillimin e komuniteteve rurale për tu aftësuar në mënyrë dixhitale. Qëllimi është të ndihmohen pronarët e vegjël të fitojnë diversifikimin e të ardhurave duke mundësuar punësim brenda dhe jashtë fermës dhe mundësi biznesi për sot dhe të ardhmen.

Punësimi i denjë është thelbësor për dinjitetin njerëzor. Ne kemi nevojë për punësim dhe shërbime të denjë rurale, duke nxitur barazinë gjinore dhe duke mbështetur komunitetet rurale. Në të njëjtën kohë, qeveritë duhet të ofrojnë programe të mbrojtjes sociale në kohë dhe të synuara mirë që mbrojnë kategoritë vulnerabelë.

Le të jetë kjo Ditë Botërore e Ushqimit një kujtesë për nevojën për të përshpejtuar këto përpjekje dhe për të luftuar për një të ardhme ku askush nuk do të mbetet pas dhe ku të gjithë të kenë akses në ushqim të shëndetshëm dhe të përballueshëm.

Të ndihmojmë fermerët në disa fronte kryesore të vjeshtës

(Vijon nga faqja 7)

Mbjellja e sipërfaqeve të mëdha të grurit, do t'i thotë ndal importit të mbi 250 mijë ton grurë në vit. Dhe do të ndikojë në mbjelljen e më shumë dhe përmirësimin e gjendjes ekonomike të fermerëve. U bëjmë thirrje fermerëve të mbjellin sa më shumë grurë në çdo formë dhe në çdo mënyrë, të mbjellin me cilësi dhe të sigurojnë të gjitha shërbimet e nevojshme si kullimi, dhe ujitja. Në periudhën e

vjeshtës, kryesisht tetor-nëntor zonat e Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut, mund të mbjellin shumë kultura si Jonxhën, Qepën ose Preshin, Bizelen, Sallatën, Spinaqin etj kultura. Për këtë të shfrytëzojmë kohën e nevojshme pa vonesë.

SIGURIMI E RUAJTJA E BAZËS USHQIMORE DHE STREHIMI I BLEGTORISË

Periodha Tetor e deri në fund të Dhjetorit kërkon shumë kujdes tek Blegtoaria, si në

grumbullimin dhe ruajtjen e bazës ushqimore nga dëmtimet e kohës. Manipulimin e kësaj me kujdes, silazhimin dhe afrimin e bazës pranë stallave. Shumë kujdes të tregohet për riparimin e stallave ku mbahen bagëtitë dhe sigurimin e kushteve të ngrohta për to.

Kemi besim për të gjithë problemet që trajtohen që të ketë një prekupim serioz nga Bashkitë, Drejtoritë e Bujqësisë, Bordet e Kullimit dhe nga të gjithë strukturat që ndihmojnë fermerin shqiptar.

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE LUSHNJE

Jemi në muajin Tetor në periudhën e vjeshtës dhe për kultivuesit e perimeve si për mjediset e mbrojtura dhe për mjediset fushore është kohë shumë e ngjeshur e intensive e ngarkuar me mbjellje, shërbime e vjelje. Kushtet klimatike karakteristike të kësaj periudhe janë të ndryshme nga vitet e tjera pasi temperaturat kanë një luhajtje të tillë, shumë freskët natën e shoqëruar me vese dhe shumë të nxehta orët e mesditës. Këto kushte kanë nxjerrë në plan të parë kontrollin e përditshëm e të kujdesit të bimëve të mbjella në fushë e në serrë, për mbrojtjen e tyre nga infeksionet e shpeshta e të menjëherëshme si nga vrugu, alternaria, botritis të ndryshme të bimëve e të frutave si dhe shfaqjen e një numri të konsiderueshëm të dëmtuesve. Për përbalimin e kësaj situatë këshillojmë alternimin e masave kimike të luftimit me ato biologjike, me preparate të rekomanduara më parë nga ne dhe në teknologjitë e kultivimit të çdo kulture, me ruajtjen e mikroklimës në serrë nëpërmjet ajrimit të mirë të serrës dhe manovrimit me kujdes sidomos në ditët me mjergull dhe netët me "vese" të lartë.

Vëmendje të madhe duhet të kushtojme, për mbrojtjen e bimëve të mbjella në fushë e në serrë nga dëmtuesit e

KËSHILLA PËR FERMERËT PERIME RITËS PËR PERIUDHËN TETOR 2022

tokës, Tutabsoluta, Tenjat minuese, Krimbi i boçes së pambukut, Krahëbardha e serrave, Tripset, Merimngat etj. Nga komunikimi ynë me fermerë, kontrollat në fushë por dhe në tregun e perimeve vërejmë se infeksionet nga këta dëmtues dhe dëmet atje ku nuk është luftuar me kujdes janë të konsiderueshme si në dëmtim të frutave ashtu edhe të pamjes tregtare të tij. Ndaj duhet të tregohet kujdes, në kombinimin e preparateve për mbrojtjen e bimëve (PMB), krahas të tjerave të tregohet kujdes për mikroklimën në serra.

1- Në pjesën dërmuese në mbjelljet e dyta dhe të vjeshtës bimët janë në fazën e rritjes intensive të bimës e të frutave, ndaj plehërimi me norma të plota të plehrave duke "anuar" nga plehrat potasike kur kemi faza të fundit të rritjes së frutave, dhe plehërim të ballancuar në fazat më të hershme.

Përveç shërbimeve të përgjithshme të përmendura deri me tani në serrat e mbjella me domate e trangull, kujdes i veçantë tregohet për heqjen e sqetulloreve, rrallim-

in e heqjen e gjetheve dhe këputjen e majës, duke iu referuar për çdo ditë gjendjes së bimëve dhe teknologjive specifike të kultivimit.

2- Tërheqim vëmendjen e të gjithë fermerëve që me kultivimin e perimeve kanë mbështetur biznesin e tyre dhe sigurimin e të ardhurave, se fundi i muajit shtator, tetor dhe 10-ditori i parë i nëntorit është një periudhë intensive mbjelljesh të farishteve të domateve të hershme për serra me ngrohje 20-31 tetor.

- Dora e parë (tetor-15 nëntor) e mbjelljes së bizeles për prodhim të hershëm në fushë, për konsum 15 prill - 15 qershor me lloje të hershme, bizele barbuje etj.

- Dora e dytë e spinaqit në fushë 10/10-10/11 për konsum. Dhjetor - mars.

- Dora e parë dhe e dytë e spinaqit në serrë (5-15/10 dhe 25/10-15/11 për konsum fundi i muajit nëntor deri në mars.

- Mbjellja e sallatës në fushë e në serrë me duar me interval 7-10 ditë nga njëra

tjetra. Mbjellja e dorës së dytë në fushë, të qepës me fidan për qepë të njoma e gjysëm të thatë në vartësi të gjendjes së tokës e të fidanit me duar në interval 10-15 deri në fillim të ngricave.

- Dora e dytë dhe e tretë e farishteve të lulëlakrës në serrë përkatësisht fundi i shtatorit-fillimi i nëntorit.

Shërbimet në kulturat e fushës, për lakrat, lulëlakra, preshin, spinaqin, sallatën, qepët me fidan, erzat etj. Tani ndërhyhet me prashitje të plota e të kujdeseshme dhe me plehërim të ballancuar. Tërheqim vëmendjen fermerëve për të luftuar tendencën, dëshirën e shfaqur në shumë raste për plehërim të njëanshëm azotik. Është e njohur tashmë dukuria, se plehërimi i njëanshëm azotik tek perimet gjetore i ul bimës rezistencën ndaj temperaturave të ulëta dhe rrit shkallën e dëmit nga ngricat, ndërsa në lakrat provokon mos lidhje të kokrës ose formimin e kokave boshe.

Futja në stinën e vjeshtës. Është mirë t'u kujtojmë fermerëve mbajtjen në gatishmëri të rjetit kullues pasi sasia e reshjeve mund të jetë e lartë dhe të jenë të përbalueshme që mos të kemi përmbajtje të prodhimeve si në mjedise të mbrojtura (serra) ashtu dhe në fushë.

Drejtorja e Teknologjive të Perimeve: QTTB-Lushnje
E-mail: qttblushnje@yahoo.com

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE KORÇË

FERMERË:

Kjo rubrikë këshillash është për të ushqyerit e dhenëve në fazën e dytë të barsmërisë, para pjelljes.

Kjo periudhë është kritike në të ushqyerit e dhenëve sepse kapaciteti ngrënës është i ulët 1.2 kg LTH, (pra sa gjysma e kapacitetit ngrënës të një deleje në muajin e dytë të laktacionit), ndërsa nevojat në lëndë ushqimore janë të larta. Një i ushqyer defiqitar gjatë kësaj periudhe do të sjellë:

- Uljen e peshës së qingjave në lindje.
- Dobësim i deleve si rezultat i harxhimit të rezervave trupore

Prandaj për këtë periudhë duhet të bëhet t'usqyerit korrekt i deles (deleve) për të evituar pasojat negative të përmendura më lart dhe për të garantuar këto objektiva:

KËSHILLA PËR FERMERËT QË MBARËSHTOJNË BAGËTI TË IMTA

- Qingja me peshë më të lartë në lindje.
- Prodhimtari qumështi më të lartë si në fazën e mëmëzimit të qingjave ashtu edhe në sezonin e mjeljes.

Ju këshillojmë që për këtë periudhë të përdoret ky racion ushqimor:

Për zonat fushore dele me peshë 45-50 kg

Llojet e ushqimeve	6 javë para pjelljes
Kullotë	4-6 kg
Bar ose jonxhë e thatë	0.2 kg
Tagjira	0.2 kg

Drejtorja e Teknologjive Blegtorale: QTTB- Korçë:
E-mail: qttbkorce@yahoo.com

Për zonat malore dele me peshë 45-50 kg

Llojet e ushqimeve	6 javë para pjelljes
Jonxhë cilësi e mirë	1.2 kg
Tagjira	0.2 kg

:Kullotë nëse ekziston mundësia

Ju kujtojmë se duhet të përfundoni menjëherë (një muaj para pjelljes) masat parambrojtëse si vaksinimi kundër Enterotoxemisë (zorëza), Agalaksisë (hirëza), Paratifo/Chlamodiosës (dështimet) dhe në rastet ku është problem sëmundja e mishit të bardhë

në qingja bëni trajtim parambrojtës të deleve barsa me Selen dhe vit E. Për të gjitha këto këshillohu me specialistin veterinar.

Për fermat e dhive:

Vazhdoni të mbani në kontroll tufën e dhive në këto drejtime:

- Ndërzimin e dhive.
- Ndërzimin e dhive për kthimet e mundëshme të afshit brënda cikleve.
- Shikoni gjëndjen e cjepeve dhe mos tejkaloni ngarkesën e tyre.
- Mos ndryshoni ritmin e të ushqyerit të dhive, dhe për dhinë e dobëta bëni trajtim të veçantë me Koncentrate.
- Zbatoni masat parambrojtëse shëndetësore sipas kalendarit të shërbimit veterinar. Këshillohu me veterinerin.

Për sqarime të tjera kontaktoni:
Sotiraq Jankulla cel: 0682630700
E-mail: sotiraqjankulla@yahoo.com

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE SHKODËR

Nëse muaj shtator nuk kishte ndonjë ngarkesë për Fermerët në lidhje me kulturat e BAM; në muajin Tetor fillojnë punimet për një cikël të ri prodhimi që ka të bëjë kryesisht me:

1. Shërbime për të marrë një prodhim të dytë zëvendësimi i bimëve të dëmtu-

ara

2. Mbjelljet e reja (përgatitja e tokave, mbjellja e fidanave në fushë)

3. Dorëzimi i prodhimeve të mbetura Bimët Aromatiko Mjekësore përgjithësisht janë bimë shumë vjeçare; janë shumë

rezistente ndaj thatësirave të verës që karakterizohen nga një periudhë qetësie të shkurtër.

Vjeshta është një periudhë zgjimi dhe punë për pjesën më të madhe të tyre.

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE SHKODËR

(Vijon nga faja 11)

Riaktivizimi i tyre për një proces vegjetativ bëhet shumë shpejt mbas shirave të vjeshtës.

Mbasi kanë kaluar periudhën e verës në kushte të thatësirës; me rënien e shirave të vjeshtës kemi një zgjim të shpejtë të tyre, me një vegjetacion të fuqishëm (sidomos bima e Sherebelës që nxë dhe sipërfaqen më të madhe të B.A.M.); dhe fermerët në këtë kohë duhet të ushtrojnë kujdesin e nevojshëm për të marrë një prodhim të dytë; duke kryer shërbimet e nevojshme kultivime dhe ushqime suplementare.

Zëvendësimi i bimëve të dëmtuara do të ishte mirë që të realizohej në këtë kohë. Kalimi i një vere shumë të gjatë pa reshje, me thatësira dhe temperatura të tejskajshme, ka bërë që një pjesë e këtyre bimëve të thahen (të dëmtohen). Me rënien e shirave pathuajse të gjitha bimët kanë filluar aktivizimn e tyre kështu që mund të dallohen fare qartë se cilat janë tharë krejt dhe mund të ndërhyhet fare mirë për zëvendësimin e tyre me bimë të tjera.

KËSHILLA DHE PROBLEMATIKA PËR FERMERËT QË KULTIVOJNË BIMË AROMATIKE MJEKËSORE, TETOR 2022

Mbjelljet e reja

Plugimi i tokave, plehërimet bazë dhe përgatitjet e tyre për mbjelljet e vjeshtës duhet të jenë përfunduar ose duhet të përfundojnë në mënyrë më urgjente.

Shumë Fermerë kanë mbjellë farishte gjatë verës, dhe kanë fidana të përgatitur dhe të gatshëm për t'i hedhur në fushë (vëndin e përhershëm). Muaj Tetor dhe Nëntor është koha më e përshtatshme (falë dhe kushteve që po krijohen me rënien e shirave në këtë periudhë), për të filluar mbjelljen fidanave në vendin e përhershëm për këtë qëllim të bëhet piketimi i parcelave që do të mbillen.

Mbjelljet e vjeshtës dhe sidomos ato që realizohen nga data 15 Tetor deri me 15

Nëntor janë shumë rezultative dhe premtojnë për të ardhmen.

Ekspierencat disa vjeçare tregojnë se mbjelljet në këtë kohë kanë epërsi ndaj mbjelljeve në pranverës për disa arsye si:

% e zënies është shumë më e lartë se mbjelljet në pranverë kjo falë kushteve klimatike natyrore të favorshme (temperaturë, lagështirë etj.); bima e sapombjellë do lidhet më mirë me tokën, do grumbullojë lëndë rezervë për të dalë në pranverë më të fuqishme dhe do ketë një zhvillim rrënjor dhe trupor më të madh se një bimë e mbjellë në pranverë; kostoja e mbjelljes ulet sepse nuk kemi nevoj të përdorim ujite për vadijen e fidanave të sapombjellur; do të rriten të ardhurat për faktin se nga bimët që mbillen në

vjeshtë prodhimi i vitit të parë do të jetë 50% më i madh se po të mbillen në pranverës; gjatë gjithë shkallës së zhvillimit të tyre bimët do të kenë një uniformitet më të madh.

Në magazinat e grumbulluesve, hangarët e fermerëve etj., ku janë të depozituara BAM duhet të merren masa për ajrosjen e prodhimeve pasi me rritjen në vazhdimësi të lagështirave mbi 80% ekziston rreziku i dëmtimit të prodhimit (sidomos bimët që janë korur me vonësë dhe nuk janë tharë sipas standardeve).

Për ndonjë prodhim të mbetur në hangare të pashitur akoma, Fermerët të kontaktojnë me grumbullues për shitjen e tij dhe të bëjnë paketimin dhe ambalazhimin e prodhimit; mbasi lagështira e madhe në këtë periudhë dhe faktorë të tjerë atmosferikë mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e produktit.

Për sqarime të mëtejshme kontaktoni:
Gjelosh Kronaj QTTB-Shkodër
Tel: 0673798499
e-mail: gjeloshkronaj@hotmail.com

Drejtorja e Teknologjive Bujqësore, QTTB-Shkodër,
E-mail: qttbshkoder@yahoo.com

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORË

Kulturat e ullirit preket nga një numër i madh dëmtuesish dhe sëmundjesh të cilat kur nuk mbahen nën kontroll shkaktojnë dëmtime shumë të mëdha jo vetëm në prodhim por edhe në ekzistencën e vetë bimës. Vitet e fundit këta parazitë kanë një përhapje më të madhe e nxitur kjo nga intensifikimi i madh i prodhimit bujqësor, qëndrueshmërisë dhe përshtatjes të këtyre parazitëve ndaj preparateve të ndryshme që përdoren në bujqësi, neglizhencës për të monitoruar në kohë shfaqjen e tyre, importimit të materialit mbjellës nga shtetet rreth vendit tonë, mungesën e laboratorëve për kryerjen e analizave në pikat e hyrjes, kontrollit të pamjaftueshëm karantinor etj. Në ullishtat në prodhim qëllimi kryesor është të rivendoset një ekuilibër agroekologjik në të cilin parazitët dhe patogjenët mund të ekzistojnë në nivele të tilla pa shkakuar dëme të konsiderueshme ekonomike. Pas shkakimit të dëmeve shumë të larta, të cilat kanë disekuilibruar ekosistemin si pasojë e trajtimeve të shpeshta kimike pa kritere, është bërë e nevojshme të rivlerësohen në agroekosistem të gjithë faktorët e dobishëm për të riekulibruar mjedisin duke e bërë atë më kompleks. Ullishtja si një përfaqësues më e vjetër e agroekosistemit të Mesdheut paraqitet mjaft e stabilizuar megjithëse pret dhe strehon një numër të papërcaktuar të një entomofaune dhe insekteve të tjera indiferente. Megjithëse parazitët dhe patogjenet e ullirit janë në një

numër të madh (jo më pak se 270 nga të cilat 140 janë insekte), shumë rrallë këto mund të krijojnë probleme shqetësuese dhe vetëm 2 apo 3 konsiderohen si dëmtues kyç.

Sëmundjet e ullirit

Syri i palloit. (Spilooceae oleagina (Cast.) Hugh).

Syri i palloit është një nga sëmundjet kryesore të ullirit. Nga monitorimet e bëra është vërejtur se kjo sëmundje është e përhapur në të gjithë zonën e kultivimit të ullirit. Bllloqe të tëra me ullinj shekullor janë prekur rëndë nga kjo sëmundje dhe jo vetëm që nuk japin prodhim por po vihet në pikëpyetje ekzistenca e vet bimëve të ullirit. Zhvillimi i kësaj sëmundje është i lidhur ngushtësisht me ecurinë klimatike, dhe duke qenë se periudha e inkubacionit të kësaj sëmundje është shumë e gjatë, efikasiteti i strategjisë së kontrollit mund të vërehet mbas disa muajsh. Shtimi i sipërfaqeve të ullishtave kërkon që nga fermerët dhe specialistët të vlerësohet seriozisht kontrolli i kësaj sëmundje në rast se duam që të kemi efektivitet në prodhimin e ullirit. Është pikërisht prej nga syri i palloit i ullishtave mbjellë me kultivarin Kalinjot të cilat karakterizohen nga një prodhim minimal. Kjo ka bërë që për këtë kultivar të ngrihet padrejtësisht opinion se ai nuk po prodhon prej disa vjetësh.

Drejtorja e Teknologjive të Pemëtarisë: QTTB-Vlorë
E-mail: qttbvlore@yahoo.com

SËMUNDJET KRYESORE TË ULLIRIT

Simptomat dhe epidemiologjia

Kjo sëmundje prek kryesisht gjethet e ullirit por nuk përjashtohet mundësia e prekjes të organeve të tjera si: fruta, bishtat dhe lastarë të rinj duke shkakuar dëmtime shumë të rënda në bimën e ullirit dhe në prodhim. Në faqen e sipërme të gjethes formohen njolla të vogla kafe, të rrumbullakta të veçuara por në raste të infeksioneve të rënda edhe të bashkuara. Gjatë muajve të verës, përreth njollave të tilla formohet një unazë e qartë me ngjyrë të kuqërremtë ose kafe në të gjelbër e cila dallohet mirë në sfondin e gjelbër të gjethes. Këto njolla të kujtojnë njollat e pendëve të bishtit të palloit nga ku ka marrë edhe emrin Syri i palloit. Në pjesën e poshtme të gjethes, simptomat dallohen rrallë përveçse në nervaturat e vetë gjethes. Në lastarët e rinj një vjeçar, mund të paraqiten infeksione që shfaqen me njolla kafe të ngjashme me ato të gjethëve. Temperaturat optimale për zhvillimin e sëmundjes janë nga 13-20°C, me një minimale 3-5°C dhe maksimale 28-32°C. Periudha e inkubacionit mund të ndryshoj nga 15-20 dite deri në disa muaj (3-5) në varësi të kushteve klimatike dhe qëndrueshmërisë të vet bimës së ullirit.

Dëmi

Dëmin më të madh kjo sëmundje e shkakton në gjethet, të cilat preken dhe bien

para kohe. Me rënien e parakohshme të këtyre gjethëve sythat që gjenden në bazën e gjethëve të cilët zakonisht janë lulore reduktohen duke shkakuar një rënie të ndjeshme të prodhimit që ndonjëherë arrin deri në 80% e më lart. Në raste të rralla një rënie e parakohshme e përsëritur e gjethëve si rezultat i infeksioneve të rënda mund të çojë deri në tharje të degëve të reja. Ndërsa prejkat e bishtave të frutave të ullirit provokojnë rënien e parakohshme të frutave. Kultivarët më të prekshëm të ullirit janë Kalinjoti, KM Beratit, KM Elbasanit e me pak Frantoio dhe Lecino.

Strategjia e kontrollit.

Ndërhyrjet agronomike.

- Përzgjedhja e kultivarit. Është shumë e rëndësishme që fermeri para se të marrë vendimin për të mbjellë ullinj duhet të përcaktojë kultivarin që përshtaten me vendin dhe terrenin ku do të mbjellë, bllokun e ullinjve. Jo të gjithë kultivarët kanë qëndrueshmëri të njëjtë ndaj Syrit të palloit dhe që mund të mbillen në zona të ndryshme. Konkretisht varieteti Kalinjot shkon mirë në zona të larta, ku sigurohet një ajrim më i mirë, me një lagështi ajrore të pranushme, në toka me kullim të mirë. Kultivarët e huaj si Frantoi dhe Lecino të cilët kohët e fundit po gjejnë një përhapje të madhe në Shqipëri shkojnë mirë edhe në zonat fushore ku është siguruar një kullim i mirë.

(Vijon në numrin e ardhshëm)

KËNDI I EKSPERTIT

Kalendari bujqësor, muaji nëntor 2022

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

Pamja e qiellit gjatë muajit nëntor 2022
Më 4, 5 nëntor - Shiu meteorik i Tauridit. Tauridët janë një shi i vogël meteorësh që

në 54% të rasteve. Për referencë, më 7 dhjetor, dita më e vrenjtur e vitit, shansi i kushteve të mbuluara me re ose më së shumti me re është

Parashikimi i motit për muajin nëntor 2022 në Tiranë (Zona bregdetare)

Dt.	Temperatura e ajrit °C		Temp. reale që ndjehet °C	Shiu		Era				UV Indeks	Zhvillimi i reve dhe reshjet	Simboli
	U	L		mm	Orë	Km/Orë		Drejtimi				
						D	N	D	N			
1	15	23	12/22/2022	0	0	15	19	JL	J	1	Kryesisht me re	
2	15	23	12/23/2021	0	0	17	16	JL	J	2	Periudhë me diell	
3	14	23	11/22/2022	0	0	19	19	JL	J	3	Duke u kthyer vranësira	
4	14	22	9/23/2021	4.4	3	4	11	JJP	JL	2	Disa shira në mëngjes; pastaj retë dhe copa dielli	
5	13	20	11/18/2018	30.4	9	19	13	JL	J	1	Re të shumta, periudhë me shira në mëngjes, pasdite me shi e stuhi	
6	13	19	11/18/2018	14.9	7	9	7	J	J	1	Vranësirë e konsiderueshme me shira dhe stuhi, kryesisht në fillim të ditës	
7	13	18	13-17-17	16.8	8.5	15	6	JP	J	1	Vranësira e konsiderueshme me reshje shiu që zvogëlohen në disa rrebeshe	
8	12	18	13-19-19	0	0	6	2	LVL	L	1	Kohë me vranësira dhe diell	
9	12	20	11/20/2020	0	0	7	4	LJL	JL	1	Kohë me vranësira dhe diell	
10	12	20	9/22/2020	0	0	6	11	PVP	VL	3	Pjesërisht me diell	
11	11	21	9/22/2020	0	0	13	13	LVL	LVL	3	Pjesërisht me diell	
12	10	20	8/21/2019	0	0	6	9	L	JL	3	Kryesisht me diell	
13	12	19	7/18/2018	0	0	13	15	JL	JL	2	Kryesisht me re	
14	12	17	8/17/2016	3.7	2.5	15	13	JJP	JJP	2	Kryesisht me re me ndonjë stuhi përreth	
15	11	19	4/17/2017	23.4	8.5	30	35	J	JP	1	Kohë me erë me periudha me shi	
16	11	19	6/18/2018	3.7	2.5	20	19	P	JP	1	Shi në mëngjes; pastaj vranësira të konsiderueshme	
17	12	18	10/16/2016	10.9	5.5	24	13	PJP	P	1	Një mbulesë e trashë resh me disa shira dhe stuhi	
